



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA HIMARË

NJËSIA E HARTIMIT TË DOKUMENTAVE TË TENDERIT

Nr. _____ prot.

Himarë, më ____ . ____ . 2026

PROCESVERBAL – TIPI I KONTRATËS-PUNË

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE
PËR KUALIFIKIM**

OBJEKTI I PROKURIMIT: “Ndërtimi i KUZ Borsh”

Lloji i kontratës: Punë publike, Projektimi dhe realizimi i punëve (Kontratë me çelësa në dorë)

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV): 45232421-9 Punime për trajtimin e ujërave të zeza; 45252100-9 Punime ndërtimi për impiante të trajtimit të ujërave të zeza; 71000000-8 Sherbime arkitektonike,inxhinierike,ndertimi dhe inspektimi

VLERA E FONDIT: 500,000,000 (pesëqindë milion lekë) pa TVSH, vënë në dispozicion nga buxheti i Bashkisë Himarë, i ndarë në tre vite financimi, konkretisht:

- **Viti 2026 41,666,667** (dyzet e një milionë e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë mijë e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e shtatë lekë) **pa tvsh.**
- **Viti 2027 250,000,000** (dyqinde e pesedhjetë milion lekë) **pa tvsh.**
- **Viti 2028 208,333,333** (dyqind e tetë milionë e treqind e tridhjetë e tre mijë e treqind e tridhjetë e trelekë) **pa tvsh.**

Perilogaritja e fondit limit dhe specifikimeve teknike është kryer nga inxhinier i licensuar referuar nenit 76 të pikës (a) të VKM-së me nr.285, datë 19.05.2021 të Këshillit të Ministrave “Për rregullat e prokurimit publik” i ndryshuar, që përcakton “çmimet e botuara nga Instituti i Statistikave (INSTAT), ose/dhe çmime të tjera zyrtare, të njohura nga institucionet përkatëse (si për shembull, nga organet tatimore a doganore, dhomat e tregtisë, në manuale etj”, Inxhinieri është mbështetur ne manualin teknik te çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe analizave teknike të tyre bazuar ne ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, të ndryshuar. - VKM nr. 216, datë 13.04.2023 “Për krijimin dhe funksionimin e sistemit të integruar për informatizimin e manualit të çmimeve për zërat e punimeve” - Udhëzimi nr.2, datë 08.05.2003 “Për klasifikimin dhe strukturën e kostos së punimeve të ndërtimit”, të ndryshuar. me qëllim që vlera limit e kontratës, të jetë një vlerë e matshme dhe njëkohësisht e të krijojë mundësinë e pjesëmarrjes së sa më shumë operatorëve ekonomikë.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor **Bashkia Himarë** ka hartuar procesverbalin për argumentimin

dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

- a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8,*
- b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.

Kriteret e mësipërme janë vendosur në përputhje me Nenin 82 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit” dhe Neni 83 “Sigurimi i ofertes”, të Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” si dhe në mbështetje të nenit 30, pika 1, të VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik: citojmë Neni 83 i LPP “*Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël*”, Neni 82, i LPP “1. *Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoritetet ose entet kontraktore pranojnë si provë paraprake në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas parashikimeve të këtij ligji. Përmbajtja e këtij formulari përcaktohet në rregullat e prokurimit publik*”.

2.1 Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale:

Sipas kriterëve të përgjithshme të përzgjedhjes/kualifikimit pika 1 e kësaj shtojce (Shtojca 7).

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

- 2.2.1 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare **2023, 2024, dhe 2025** lëshuar nga administrata tatimore , ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se vlera e parashikuar e kontratës që po prokurohet.

(Kjo kërkesë do të konsiderohet e përmbushur nëse Operatori ekonomik arrin vlerën e xhiros minimale në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga Autoriteti Kontraktor).

Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, ky kusht, plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit, në raport me përqindjen (elementët konkretë) e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.

- 2.2.2 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin bilancet vjetore, për vitet financiare **2023, 2024, dhe 2025**, të konfirmuara me vulë pranë autoriteteve përkatëse (Administratës Tatimore), dhe të shoqëruara me Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabël të Autorizuar, vetëm në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve të *ligjit Nr.10 091, datë 05.03.2009*, ku bilancet e dy viteve të njëpasnjëshme, nuk duhet të kenë raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivit.

Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, ky kusht, plotësohet nga secili anëtar i bashkimit

2.2.3 Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të ketë shlyer taksat për vitin **2025 dhe 2026** për adresën ku ai ushtron aktivitet sipas Ekstraktit Historik lëshuar nga QKR, ku të përfshihet kësti për periudhën përkatëse të maturuar, sipas përcaktimeve të ligjit nr.9632, datë 30.10.2006 “*Për sistemin e taksave vendore*”, i ndryshuar, ku nëse kualifikohet, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, duhet të paraqesë vërtetim/e lëshuar nga Bashkia me anë të së cilit të vërtetohet shlyerja e këtyre taksave sipas vetëdeklarimit të kryer në shtojcën 8 të DST-së.

Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, ky kusht, plotësohet nga secili anëtar i bashkimit.

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në Nenin 77 pika 1/b dhe 3 të Ligjit Nr.162/2020 “*Për Prokurimin Publik*” të ndryshuar, ku përcaktohet: “1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në: b) **gjendjen ekonomike dhe financiare**; .3. Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën. Për këtë qëllim autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë në veçanti që operatorët ekonomikë të kenë një xhiro vjetore minimale të caktuar. Gjithashtu, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore që të tregojnë raportet ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Në nenin 43 “*Kërkesat për kapacitetet ekonomiko financiare*” të VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “*Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik*” të ndryshuar, **paragrafi 1 dhe 2 germa “b”**, parashikohet: Autoriteti/enti kontraktor, për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, kërkon kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar nga operatori ekonomik, për një periudhë maksimumi deri në 3 (tre) vitet e fundit financiare¹. Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë: b) vlerën e përllogaritur të kontratës ose lotit, në procedurat e prokurimit ndërmjet kufirit të lartë dhe të ulët monetar; Nëse vlerësohet, autoriteti/enti kontraktor mund të kërkojë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore, për një periudhë maksimumi tre vitet e fundit financiare, që të tregojnë raportet, ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit. Kjo kërkesë konsiderohet e përmbushur nëse në dy bilance të njëpasnjëshme, nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit. Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke i'u referuar legjislacionit të fushës, konkretisht: Ligjit Nr. 8438 datë 28.12.1998 “*Për tatimin mbi të ardhurat*”, i ndryshuar, neni 29 i tij i cili përcakton: “*Çdo tatimpagues përgatit deklaratën vjetore të të ardhurave të tatueshme në formën e përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaratën vjetore në organet tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës, duke paraqitur në të njëjtën kohë bilancin kontabël, së bashku me anekset e tij, si dhe çdo të dhënë tjetër të përcaktuar në Udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji; Udhëzimit të Ministrit të Financave Nr.5 datë 30.01.2006 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, Pika 3.12 e tij, si dhe kërkesave të Ligjit Nr. 25 datë 10.05.2018 “Për Kontabilitetin dhe pasqyrat financiare” neni9 ku parashikohet: “Kohëzgjatja e periudhës raportuese është 12 muaj. Periudha raportuese fillon në datën 1 janar dhe përfundon në datën 31 dhjetor. Përjashtimet për veprimtaritë e veçanta, me propozimin e Këshillit Kombëtar të Kontabilitetit, miratohen nga ministri përgjegjës për financat”; Ligjit Nr.10091 datë 05.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të audituesit ligjor dhe të kontabilistit të miratuar” (i ndryshuar) neni 41 i tij, Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.922, datë 29.12.2014 “Për deklarin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet formës elektronike”. Ne keto kushte, vleresojme të kërkojme kete dokumentacion pasi tatimpaguesit (operatorët ekonomikë) kanë detyrimin të dorëzojnë në administratën tatimore brenda **datës 31 mars të vitit pasardhës** bilancin*

kontabël së bashku me anekset e tij si dhe akt ekspertizen e Ekspertit Kontabël të Autorizuar në rastet kur plotësohen kushtet e parashikuara nga ligji.

Njësia e prokurimit kërkoi edhe **pagesat e taksave vendore** bazuar në Ligjin Nr.9632 datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”(te ndryshuar), neni 5, pika c, sipas afateve të miratuara të kryerjes së pagesave të percaktuara nga çdo njesi e qeverisjes vendore si dhe faktit se në zbatim të legjislacionit në fuqi, Qendra Kombëtare e Biznesit ka funksion të mbajë rregjistrin tregtar dhe për qëllim të rregjistrimit fiskal, ku përcaktohen dhe vendet e ushtrimit të operatorëve ekonomikë, duke qenë se këto të fundit kanë detyrimin të paguajnë të gjitha detyrimet e taksave dhe tarifave vendore, në vendet që ushtrojnë aktivitetin e tyre, atëherë operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të vërtetojnë se i kanë likuiduar këto detyrime nëpërmjet paraqitjes së vërtetimit të lëshuar nga Administrata e Qeverisjes Vendore.

U përcaktuan kriteret për kapacitetet ekonomike dhe financiare si më lart, duke qenë se këto kriteret janë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me objektin e kontratës, dhe i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes financiare të operatorëve ekonomikë dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen me sukses të kontratës.

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1 Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti kontraktor kërkon:

- Punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se **50 %** e vlerës së përllëgëritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës;
ose
- punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e vogël se dyfishi i vlerës së fondit limit të kontratës që prokurohet.

Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme.

Për plotësimin e këtyre kriterëve Operatori Ekonomik duhet të paraqesë:

- a) Në rast se punimet janë kryer me ente publike: Autoriteti Kontraktor, si dëshmi për përvojën e mëparshme kërkon:
 - i. Kontratën e Sipërmarrjes,
 - ii. Situacionin përfundimtar të objektit
 - iii. Faturat Tatimore të miratuara sipas legjislacionit tatimor të delaruara në organet tatimore
 - iv. Aktin e Kolaudit të objektit
 - v. Formular Vlerësimi nga Investitori sipas shtojcës nr. 9
 - vi. Në rast se kontrata e ngjashme është lidhur nga një bashkim operatorësh ekonomikë duhet të paraqitet edhe kontrata e bashkëpunimit midis tyre.
- b) Në rast se punimet janë kryer në sektorin privat: Autoriteti Kontraktor, si dëshmi për përvojën e mëparshme kërkon:
 - i. Kontratën e Sipërmarrjes,
 - ii. Situacionin përfundimtar të objektit
 - iii. Faturat Tatimore të miratuara sipas legjislacionit tatimor të delaruara në organet tatimore
 - iv. Aktin e Kolaudit të objektit
 - v. Formular Vlerësimi nga Investitori sipas shtojcës nr. 9

Pika 1/a plotësohet nga anëtari i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontratat e ngjashme në raport me përqindjen e

pjesëmarrjes së tyre në bashkim. Kurse pika 1/b duhet të plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenin 77 pika 4 të Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” ku përcaktohet se: “Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën”

Në nenin 39 “Kërkesat të veçanta për kontratat për punë publike” pika 5 dhe 8 të VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar ku përcaktohet se: “Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti/enti kontraktor kërkon: **a) punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se 50% e vlerës së përlogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës; b) punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e madhe se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet.** Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme. Autoriteti/enti kontraktor, si dëshmi për përvojën e mëparshme, kërkon vërtetime të lëshuara nga një ent publik, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë, për të vërtetuar përmbushjen e suksesshme të punëve. Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, autoriteti/enti kontraktor kërkon si dëshmi, vërtetime, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë, e shoqëruar me fatura tatimore dhe çdo lloj dokumenti tjetër, që parashikohet nga legjislacioni në fuqi, që provon realizimin me sukses të punëve. Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kritere të tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës”.

Njësia e prokurimit përcaktoi kriteret për punë të ngjashme si më lart duke qenë se këto kritere janë të detyrueshme, janë në përpjesëtim dhe të lidhura me objektin e kontratës. Përvojat e mëparshme janë element shumë i nevojshëm që garantojnë autoritetin se operatorët ekonomikë zotërojnë kapacitete për të zbatuar kontratën me sukses sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Kriteri i kapacitetit teknik siguron se operatorët ekonomikë që marrin pjesë në procedure kanë përvojën dhe ekspertizën e nevojshme për të kryer punën me cilësi të lartë. Përdorimi i operatorëve me përvojë të mëparshme siguron që puna do të kryhet me sukses dhe pa ndërprerje. Përvoja e mëparshme në projekte të ngjashme siguron që operatorët janë të gatshëm për situata të papritura dhe janë në gjendje të menaxhojnë situatat e mundshme në mënyrën e duhur. Kriteri i kapacitetit teknik ndihmon në sigurimin e një konkurrence të ndershme dhe të përshtatshme në procedure.

Referuar këtij neni, njësia e prokurimit vlerëson se duhen kërkuar disa prej dokumentave ligjore të zbatimit të punimeve, bazuar në Ligjin Nr.8402 datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e ndërtimit”(i ndryshuar), si dhe akteve dhe VKM të dala në zbatim të tij, pasi duke qenë se kontrata për punë publike që po prokurohet është në bazë të punimeve me matje, sipas nenit 39 pika 1/a e VKM-së, lind e nevojshme që operatorët ekonomikë pjesëmarrës krahas dokumentacionit të përcaktuar në nenin 39 pika 5/a dhe b, të paraqesin dhe situacionet përfundimtare si dhe formular vleresimi për punët e kryera me entet publike. Kjo bëhet me qëllim që autoriteti kontraktor të bindet nëse operatori ekonomik zotëron përvojën e nevojshme për zbatimin e kontratës, ku punimet e mëparshme duhet të kenë zëra të konsiderueshme punimesh me zërat e punimeve që po prokurohen, si dhe në rastin kur punimet e mëparshme janë kryer si bashkim

operatorësh ekonomikë, nuk jepet informacion mbi përqindjen e anëtarëve në bashkim, në vërtetimet që lëshojnë autoritetet kontraktore dhe në faturat tatimore të shitjes, ku këto të fundit lëshohen nga përfaqësuesi i bashkimit të operatorëve ekonomikë.

Meqënëse paraqitja e dokumentacionit të mësipërm, nuk sjell diskriminim dhe/ose kosto shtesë për operatorët ekonomikë pjesëmarrës, por i shërben autoritetit kontraktor për njohjen e përvojës së duhur të tyre, duke mundësuar zhvillimin normal dhe në kohë të procedurës së prokurimit, pasi nuk ka nevojë që Autoriteti të kërkojë informacione shtesë gjatë vlerësimit të ofertave (në rast mungese të informacionit të sipërcituar), njësia e prokurimit gjykon se kërkitimi i dokumentacionit të përcaktuar në kushtin e mësipërm është i nevojshëm për vërtetimin e kryerjes së punëve të ngjashme.

Gjithashtu është kërkuar në DST:

- Per kontratat e realizuara si Bashkim Operatorësh, Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë: Kontratën e Bashkimit të operatorëve ekonomik si dhe prokurën e posacme të deklaruar në fazën e tenderimit.
- Per kontratat e realizuara si Nënkontraktor, Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë: Kontratën bazë ndërmjet Kontraktorit dhe Autoritetit Kontraktor; si dhe Miratimi zyrtar si nënkontraktor i deklaruar nga ana e autoritetit kontraktor.

Argumentimi: Për kontratat e realizuara si Bashkim Operatorësh, është kërkuar edhe paraqitja e kontratës së bashkimit të operatorëve shoqëruar me tabelën e ndarjes së punimeve, ku të cilësohen punimet që ka marrë përsiper të kryejë secili anëtar i BOE, sipas parashikimeve të nenit 88 të VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar. Me anë të këtij dokumentacioni autoriteti kontraktor ka mundësi të njihet me vlerën reale të punimeve të realizuara nga ofertuesi/t, mbi bazën e një kontrate të realizuar si BOE.

Për kontratat e realizuara si Nënkontraktor është kërkuar edhe miratimi nga ana e autoritetit kontraktor, si nënkontraktor i deklaruar, në respektim të parashikimeve të nenit 89 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar.

Dokumentacioni i kërkuar si më sipër, është kërkuar me qëllim që Autoriteti Kontraktor të përllogarisë vlerën e saktë të kontratave të mëparshme të realizuara nga ofertuesi, brenda afatit të përcaktuar në pikën 2.3.1.

2.3.2 Operatori ekonomik duhet të paraqesë licencën profesionale - të shoqërisë, të vlefshme për zbatimin e punimeve objekt kontrate, lëshuar nga Ministria e Infrastruktura dhe Energjisë bazuar në formatin e miratuar me Vendim të Këshillit të Ministrave Nr. 42 datë 16.01.2008 "Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhenies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve. Licenca duhet të përmbajë kategoritë e punimeve të kontratës si më poshtë:

PER PUNIMET E PERGJITHSHME TE NDERTIMIT

Kategoria NP- 1 Punime gërmimi në tokë	Klasifikimi B
Kategoria NP- 2 Ndërtime civile dhe industriale	Klasifikimi A
Kategoria NP- 4 Rrugë, autostrada, mbikalime, hekurudha, tramvai	Klasifikimi A
Kategoria NP - 5 Punime nëntokësore, ura e vepra arti	Klasifikimi A
Kategoria NP- 7 Ujësjellës, gazsjellës, vajsjellës, vepra kullimi e vaditje	Klasifikimi E
Kategoria NP-11 Ndërtime për N/stacionet, kabinat e transformatoreve linja e TN e të mesëm dhe shpërndarjen e energjisë	Klasifikimi A
Kategoria NP-12 Punime të inxhinierisë së mjedisit	Klasifikimi A

PER PUNIMET SPECIALE TE NDERTIMIT

Kategoria NS- 1 Punime per prishjen e ndertimeve	Klasifikimi A
Kategoria NS - 8 Ndërtime parafabrikat me beton të armuar, struktura metalike dhe druri	Klasifikimi A
Kategoria NS- 9 Punime strukturore speciale	Klasifikimi A
NS - 14 Impiante të brendshme elektrike, telefonike, radiotelefoni TV	Klasifikimi A
Kategoria NS-18 Punime topogjeodezike	Klasifikimi A

Në rastet e Bashkimit të Operatorëve Ekonomikë, secili anëtar i bashkimit duhet t'i disponojë në raport me zërat, përqindjen e marrë përsipër, sipas angazhimit me shkrim / kontratën e bashkëpunimit.

Operatoret e huaj duhet te bejne ekuivalentimin e licensave profesionale qe disponojne te leshuara nga vendi i origjines, prone Ministrise se Infrastruktures dhe Energjise, (ose Ministrise kompetente te kohes) Republika e Shqiperise. (Rregullorja per kriteret dhe procedurat e dhenies se licensave profesionale te zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit te subjekteve juridike qe ushtrojne veprimtari ndertimi, e miratuar me VKM- ne, Nr.42, date 16.01.2008).

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenin 77 pika 1/a dhe 2 të ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik¹” në të cilët përcaktohet: “Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:**aftësinë teknike dhe profesionale**;...Për sa i përket përshtatshmërisë për të kryer një veprimtari profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të regjistrohen në një nga regjistrat profesionalë ose tregtarë. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë **se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike**, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie”.

Në nenin 39 “Kërkesat të veçanta për kontratat për punë publike” pika 6 të VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik” përcaktohet “Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon:a) **licenca profesionale** të shoqërisë për realizimin e punimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore;”

VKM Nr. 42 datë 16.01.2008 të ndryshuar “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licensave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimi” (lidhja 2, 3 dhe 4). Referuar zërave të punimeve që përmban preventivi i punimeve objekt kontrate, në mbështetje të Ligjit Nr.8402 datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit” (të ndryshuar), si dhe në zbatim të VKM Nr.42 datë 16.01.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licensave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”, njësia e prokurimit vlerëson se operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të disponojnë në liçensën profesionale për zbatimin e punimeve, kategoritë e kërkuara të përcaktuara sipas llojit dhe nënlojit të objektit të punimeve, si dhe klasifikimin në nivelet e kërkuara për çdo kategori punimesh, kërkesa të cilat kanë lidhje dhe janë proporcionale me objektin e kontratës. Llojet e licensave dhe niveli i klasifikimit të tyre, sipas kategorive dhe niveleve (gërmave) përkatëse janë bërë në përputhje me natyrën e punimeve respektive dhe vlerën e përlllogaritur sipas preventivit të hartuar për këtë objekt. Niveli i klasifikimit i kërkuar për kategoritë respektive është kërkuar bazuar në zërat e punimeve që parashikohen të kryhen dhe që përfshihen në kategorinë përkatëse brenda vlerave të kufijve të parashikuara në VKM Nr. 42 date 16.01.2008, të ndryshuar.

Sipas VKM Nr. 42 datë 16.01.2008 të ndryshuar, përcaktohet:

NP-1 – Punime gjurmimi në tokë – Klasifikimi B: Kjo kategori kërkohet për shkak të volumit dhe natyrës së pritshme të punimeve të gjurmimit që shoqërojnë ndërtimin e rrjetit të kanalizimeve dhe strukturave të impiantit. Punimet përfshijnë hapjen e kanaleve për vendosjen e tubacioneve, gjurmimet për pusetat, themelet dhe strukturat e impiantit, largimin dhe transportimin e materialit të gjurmuar, mbushjen e kanaleve dhe sistemimin e terrenit.

NP-2 – Ndërtime civile dhe industriale – Klasifikimi A: Kategoria lidhet me realizimin e objekteve dhe strukturave civile/industriale që përbëjnë impiantin e trajtimit të ujërave të ndotura. Në varësi të zgjidhjes teknologjike të projektit, impianti mund të përmbajë struktura betonarme, bazamente për pajisjet teknologjike, godina teknike dhe shërbimi, rezervuarë/basene dhe struktura të tjera ndërtimore të nevojshme për funksionimin e tij.

NP-4 – Rrugë, autostrada, mbikalime, hekurudha, tramvai etj. – Klasifikimi A: Kjo kategori lidhet me punimet e ndërhyrjes dhe rikthimit në gjendjen e mëparshme të sipërfaqeve rrugore të prekura nga ndërtimi i rrjetit të kanalizimeve, si dhe me realizimin e rrugëve dhe shesheve të brendshme të impiantit, nëse parashikohen nga projekti. Punimet mund të përfshijnë shtresat e nënbazës dhe bazës, ngjeshjen, asfaltimin dhe rehabilitimin e segmenteve rrugore të dëmtuara nga hapja e kanaleve.

NP-5 – Punime nëntokësore, ura dhe vepra arti – Klasifikimi A: Kjo kategori mund të lidhet me realizimin e strukturave nëntokësore dhe veprave të posaçme që mund të kërkohen për kalimin ose mbrojtjen e tubacioneve, pusetave dhe elementeve të tjera të rrjetit.

Duke qenë se procedura është “Projektim–Zbatim”, mbajtja e kësaj kategorie si kërkesë duhet të lidhet me kërkesat funksionale të objektit dhe me ekzistencën e parashikuar të punimeve nëntokësore apo veprave të artit që tejkalojnë punimet e zakonshme të kanalizimeve.

NP-7 – Ujësjellës, gazsjellës, vajsjellës, vepra kullimi dhe vaditje – Klasifikimi E: Kjo përbën një nga kategoritë kryesore të lidhura me objektin e kontratës, për shkak se pjesë thelbësore e investimit është realizimi i infrastrukturës së tubacioneve dhe rrjeteve përkatëse.

Punimet përfshijnë shtrimin dhe montimin e tubacioneve, realizimin e pusetave dhe elementeve të rrjetit, lidhjet ndërmjet segmenteve, provat dhe testimet, si dhe punimet e tjera të nevojshme për krijimin dhe funksionimin e sistemit.

Klasifikimi i kërkuar duhet të jetë në përputhje me vlerën e punimeve që i korrespondojnë kësaj kategorie brenda kontratës.

NP-11 – Ndërtime për nënstacione, kabina transformatorësh, linja të tensionit të lartë/të mesëm dhe shpërndarjen e energjisë – Klasifikimi A: Kjo kategori mund të justifikohet vetëm nëse objekti përfshin realizimin e infrastrukturës për furnizimin elektrik të impiantit, si kabinë/nënstacion transformimi, linjë të tensionit përkatës apo punime të tjera që hyjnë konkretisht në fushën e kësaj kategorie.

Impianti i trajtimit përmban pajisje elektromekanike me konsum të konsiderueshëm energjie, por vetëm ekzistenca e pajisjeve elektrike nuk është në vetvete argument i mjaftueshëm për NP-11.

Kategoria duhet të kërkohet nëse kërkesat e objektit parashikojnë konkretisht punime të kësaj natyre.

NP-12 – Punime të inxhinierisë së mjedisit – Klasifikimi A: Kjo kategori lidhet drejtpërdrejt me natyrën dhe qëllimin e investimit, pasi objekti ka në fokus trajtimin e ujërave të ndotura dhe mbrojtjen e mjedisit. Ndërtimi dhe vënia në funksion e implantit përfshin realizimin e veprave dhe sistemeve që synojnë trajtimin e ujërave të ndotura përpara shkarkimit të tyre sipas kërkesave të përcaktuara për objektin.

NS-1 – Punime për prishjen e ndërtimeve – Klasifikimi A: Kategoria mund të kërkohet nëse për realizimin e rrjetit dhe implantit parashikohen prishje të strukturave ekzistuese, shtresave të betonit, elementeve konstruktive ose objekteve që pengojnë realizimin e veprës.

Nëse dokumentet e procedurës nuk identifikojnë nevojën për punime të konsiderueshme prishjeje, kjo kategori duhet të rivlerësohet për të shmangur vendosjen e një kërkeje që nuk lidhet në mënyrë të mjaftueshme me objektin.

NS-8 – Ndërtime parafabrikate me beton të armuar, struktura metalike dhe druri – Klasifikimi A: Kjo kategori mund të lidhet me montimin e elementeve të parafabriuara prej betoni të armuar dhe strukturave metalike të implantit, përfshirë sipas projektit konstruksione mbajtëse, platforma, shkallë, struktura ndihmëse dhe elemente të tjera metalike ose të parafabriuara.

Kërkesa duhet të mbahet nëse kërkesat funksionale të implantit parashikojnë përdorimin e strukturave të tilla.

NS-9 – Punime strukturore speciale – Klasifikimi A: Kategoria justifikohet vetëm nëse natyra e objektit parashikon punime strukturore speciale, të cilat nuk mbulohen nga punimet e zakonshme betonarme apo kategoritë e tjera të kërkuara. Për shkak të natyrës “Projektim–Zbatim”, nevoja për këtë kategori duhet të mbështetet në kërkesat minimale/funksionale të Autoritetit Kontraktor dhe jo vetëm në mundësinë teorike që projekti i ardhshëm mund të përmbajë punime të tilla.

NS-14 – Impiante të brendshme elektrike, telefonike, radiotelefoni dhe TV – Klasifikimi A: Kategoria lidhet me realizimin e instalimeve elektrike të objekteve të implantit, përfshirë furnizimin dhe shpërndarjen e energjisë elektrike brenda objekteve, instalimet dhe lidhjet elektrike të pajisjeve, ndriçimin dhe instalimet e tjera që hyjnë në fushën e kësaj kategorie.

Kjo kategori është e lidhur me karakterin elektromekanik të implantit, i cili kërkon instalime elektrike për funksionimin e pajisjeve teknologjike.

NS-18 – Punime topogjeodezike – Klasifikimi A: Kategoria është e nevojshme për realizimin e matjeve topografike dhe gjeodezike që shoqërojnë projektimin dhe zbatimin e rrjetit të kanalizimeve dhe implantit.

Punimet topogjeodezike janë të nevojshme për rilevimin e gjendjes ekzistuese, përcaktimin e koordinatave dhe kuotave, piketimin e gjurmës së tubacioneve dhe strukturave, kontrollin e pjerrësive dhe kuotave gjatë zbatimit, si dhe për hartimin e dokumentacionit përfundimtar të punimeve të realizuara (as-built).

Kjo kërkesë është veçanërisht e lidhur me rrjetet e kanalizimeve me gravitet, ku respektimi i kuotave dhe pjerrësive të projektimit është element thelbësor për funksionimin hidraulik të sistemit.

2.3.3 Operatorët ekonomik pjesëmarrës duhet të disponojnë licencë projektimi ose të kontraktojë me kontratë bashkëpunimi shoqëri projektuese të licencuara sipas rregullores së miratuar me VKM nr. 943, datë 28/12/2016 “Për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale për individë dhe persona juridikë në fushën e studimit e të projektimit në ndërtim dhe mbikëqyrje e kolaudit të punimeve të zbatimit në ndërtim”.

Licenca e projektimit duhet të ketë kategoritë si më poshtë:

- **Kat. 5.b** Furnizim me ujë – kolektorë shkarkimi.
- **Kat. 5.c** Ujësjellës- kanalizime urbane – rurale.
- **Kat. 8.a** Rilevime inxhinierike.
- **Kat. 10.e** Projektim kabina elektrike të rrjetit shpërndarës–linja të tensionit të ulët–të mesëm.
- **Kat. 14** Studime e projekte të ndërtimit të impianteve të trajtimit të ujërave të zeza.

*Sqarim: Për licencat e lëshuara pas hyrjes në fuqi të Vendimit nr.943, datë 28.12.2016 “Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr.759, datë 12.11.2014, të Këshillit të Ministrave ‘Për licencimin profesional të individëve dhe personave juridike që do të ushtrojnë veprimtari në fushën e studimit e projektimit në ndërtim dhe mbikëqyrjes e kolaudit të punimeve të zbatimit në ndërtim”, Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të paraqesë **Licenca profesionale të shoqërisë (e vlefshme) për projektim (lëshuar nga MZHUT** ose institucione të tjera të autorizuar sipas legjislacionit në fuqi për dhënien e licencave profesionale në fushën e studim projektimit në ndërtim), e vlefshme, ku të përfshihen kategoritë e mësipërme me ndryshimet përkatëse në emërtesë.*

Në cdo rast AK ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik ose ti kërkojë operatorit ekonomik sqarime dhe dokumente.

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenin 77 pika 1/a dhe 2 të ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik¹” në të cilët përcaktohet: “Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:**aftësinë teknike dhe profesionale**;...Për sa i përket përshtatshmërisë për të kryer një veprimtari profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të regjistrohen në një nga regjistrat profesionale ose tregtarë. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë **se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike**, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie”.

Në nenin 39 “Kërkesat të veçanta për kontratat për punë publike” pika 6 të VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik” përcaktohet “Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon:a) **licenca profesionale** të shoqërisë për realizimin e punimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore;”

VKM Nr. 42 datë 16.01.2008 të ndryshuar “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimi” (lidhja 2, 3 dhe 4). Referuar zërave të punimeve që përmban preventivi i punimeve objekt kontrate, në mbështetje të Ligjit Nr.8402 datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit” (të ndryshuar), si dhe në zbatim të VKM Nr.42 datë 16.01.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”, njësia e prokurimit vlerëson se operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të disponojnë në liçensën profesionale për projektim, kategoritë e kërkuara të përcaktuara sipas llojit dhe nënlllojit të objektit të punimeve, kërkesa të cilat kanë lidhje dhe janë proporcionale me objektin e kontratës.

Duke qene se kontrata do te jete **Projektimi dhe Realizimi i Punimeve** dhe menyra e prokurimit do te jete **me Çelesa ne dorë**, per **(Faza IV-VI)** operatori ekonomik pjesmares do duhet te disponoje license projektimi ose duhet te kontraktoje me kontrate bashkëpunimi pjesën e hartimit te projektit te detajuar teknik.

Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në Nenin 77, pika 1 të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”; Kreut V, Seksioni III, Neni 39, pika 6/a, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.

Për sa më lart, me qëllim realizimin e punës objekt prokurimi, Autoriteti Kontraktor ka përcaktuar kërkesat për licencat profesionale të projektimit bazuar në natyrën, kompleksitetin dhe disiplinat teknike të parashikuara në Detyrën e Projektimit. Nga analiza e Detyres se Projektimit rezulton se objekti përfshin projektimin e elementëve arkitektonikë, konstruktivë, hidroteknikë, elektrikë, mekanikë dhe të sistemeve të jashtme, si dhe projektimin e sistemeve të sigurisë, mbrojtjes nga zjarri, mbrojtjes atmosferike, ventilimit dhe kondicionimit, parkimit nëntokësor, ashensorëve dhe infrastrukturës ndihmëse. Mbeshtetur ne vendimin Nr. 943, datë 28.12.2016 “Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr.759, datë 12.11.2014, të këshillit të ministrave, “për licencimin profesional të individëve dhe personave juridikë që do të ushtrojnë veprimtari në fushën e studimit e të projektimit në ndërtim dhe mbikëqyrjes e kolaudimit të punimeve të zbatimit në ndërtim”

Sipas këtij kriteri, operatori/ët ekonomik duhet të dëshmojë se disponon liçensat profesionale ose Projektuesi i kontraktuar te jete i licensuar siç parashikohet nga legjislacioni në fuqi për kryerjen e shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente.

Më konkretisht, po paraqesim argumentimet si më poshtë:

KATEGORIA E KËRKUAR	PËRSHKRIMI I KATEGORISË	ARGUMENTIMI
5.b	Projektim Furnizim me ujë – kolektorë shkarkimi	Bazuar në detyrën e projektimit, parashikohet realizimi i sistemit kanalizimeve te zones rurale, si rrjedhojë gjykohet që kjo pikë është e nevojshme për realizimin me sukses të shërbimeve të kërkuara.

5.c	Projektim ujësjiellës kanalizime urbane – rurale.	Bazuar në shërbimet e kërkuara sipas Detyrës së Projektimit, parashikohet mbulimi i plotë me rrjet kanalizimesh për të gjithë zonën e studimit duke shmangur ndotjen nga ujërat e ndotura dhe trjatinin e tyre. Realizimi i projektit të detajuar teknik përfshirë preventivin e punimeve për ndërtimin e rrjetit shpërndarës së ujësjiellës të fshatrave dhe kanalizimeve me të gjithë parametrat hidroteknik, sjell si rrjedhojë që të gjykohej se kjo pikë është e nevojshme për realizimin me sukses të shërbimeve të kërkuara.
8.a	Rilevime inxhinierike.	Bazuar në shërbimet e kërkuara sipas Detyrës së Projektimit, parashikohet të kryhet rilevimi inxhinierik i rrugëve dhe të gjithë hapësirës ku mendohet të kalojë sistemi i ujësjiellës dhe i kanalizimeve, të jepet plani i piketimit dhe verifikimi paraprak në terren për saktësinë e të dhënave, përpara fillimit të projektit të zbatimit duke qenë se sistemi i kanalizimeve funksionon me saktësim kuotash, si rrjedhojë gjykohej që kjo pikë është e nevojshme për realizimin me sukses të shërbimeve të kërkuara.
10.e	Projektim kabina elektrike të rrjetit shpërndarës–linja të tensionit të ulët–të mesëm.	Bazuar në shërbimet e kërkuara sipas Detyrës së Projektimit, parashikohet të kryhen punime elektrike në stacionin e pompimit si (transformatori, pajisje matje energjie , pajisje ndërprerje tensioni mesatraz, punime ndërtimi, linja të jashtme për furnizimin me energji të impiantit dhe STP KUZ , përpara fillimit të projektit të zbatimit., si rrjedhojë gjykohej që kjo pikë është e nevojshme për realizimin me sukses të shërbimeve të kërkuara.
14	Studime e projekteve të ndërtimit të impianteve të trajtimit të ujërave të zeza.	Bazuar në shërbimet e kërkuara sipas Detyrës së Projektimit, parashikohet të ndërtohet impiant trjatinimi i ujërave të ndotura me të gjitha zërat e parashikuar në preventivë , si rrjedhojë gjykohej që kjo pikë është e nevojshme për realizimin me sukses të shërbimeve të kërkuara.

2.3.3.1 Operatori ekonomik duhet të ketë Drejtuesit Teknikë të Përfshirë në Licencën e Shoqërisë, si më poshtë, vërtetuar me kontratë pune të vlefshme, diplomë, licensë profesionale individuale, CV, librezë pune dhe të listuar në listpagesat e Shoqërisë për periudhën e 3 (tre) muajve të fundit nga data e zhvillimit të procedurës:

- 1 (një) Drejtues Projekti Projektues Hidroteknik
- 1 (një) Projektues Ndërtimi
- 1 (një) Projektues Gjeodet/Topograf

Shënim: Kjo kërkesë përmbushet nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 10 të DST. Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit ose nëse do të jetë nevoja për t'u kërkuar sqarime nga AK.

Stafi i angazhuar të paraqesë deklaratë disponueshmërie për kryerjen e shërbimeve që ka marrë përsipër të realizojë.

Në cdo rast AK ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik ose ti kërkojë operatorit ekonomik sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime.

Argumentimi: Operatori/ët ekonomik ose Projektuesi i kontraktuar duhet të dëshmojë që ka stafin, personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin e suksesshëm të kontratës bazuar në neni 77, pika 4, të Ligjit 162/2020, “Për prokurim publik” dhe neni 41, pika 4, gërma b, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Njësia e prokurimit për vendosjen e stafit i është referuar Detyrës së Projektimit për këtë objekt pjesë e kësaj procedure, pjesë e secilave do të jenë të licensuar për shërbimet që priten të realizohen.

Më konkretisht, po paraqesim argumentimet për inxhinieret si më poshtë:

Për realizimin e këtij studim projektimi objekti nevojitet një ekip inxhinierësh të udhëhequr nga **Drejtuasi i Projektit** që ka detyra kryesore të lidhura kryesisht me drejtimin dhe koordinimin e ekipit të inxhinierëve të stafit, drjetimin e aktiviteteve kryesore për realizimin e shërbimeve, prodhimin e dokumentave kryesore si dhe raporteve që kërkohen sipas Detyrës së Projektimit, si dhe mbajtjen e kontakteve me autoritetin kontraktor. Profili i këtij pozicioni kërkohet të jetë **Projektues Inxhinier Hidroteknik** pasi ky profil i përshtaten shërbimeve të kërkuara për projektimin e sistemeve të ujësjellës-kanalizimeve.

Projektues Inxhinier Ndërtimi, kërkohet për realizimin e shërbimeve të lidhura kryesisht me projektimin e strukturave beton-arme me/pa prani të ujit të lidhura sidomos me llogaritjet inxhinierike sipas zerave të preventivit lidhur me kapitujt e ndërtimit të godinave, të pusëve, strukturave beton-arme, punimeve hekur betoni. Gjithashtu nevojitet për kryerjen e llogaritjeve inxhinierike për përcaktimin e shtresave rrugore si dhe materialit që do të përdoret për mbushjen e kanaleve ku do të shtrohen linjat e KUZ dhe ujësjellesit në rrjetin shpërndarës të fshatrave respektive me qëllim sigurimin e aftësisë mbajtëse.

Projektues Gjeodet/Topograf, kërkohet për realizimin e shërbimeve të lidhura kryesisht me rilevimin e kuotave gjeodezike, koordinative të rrugës dhe të gjithë hapësirës ku mendohet të kalojë sistemi i kanalizimeve por edhe ai i ujësjellesit, përcaktimi i vendodhjes së pusëve HDPE, gjurmët e linjave KUZ dhe kolektit sekondar dhe primar drejt pikës fundore të trajtimit, të jepet plani i piktimit dhe verifikimi paraprak në terren për saktësinë e të dhënave përpara fillimit të projektit të zbatimit.

2.3.3.2 Operatori ekonomik ose Projektuesi i kontraktuar, duhet të ketë Staf Ndihmës si më poshtë, vërtetuar me kontratë pune të vlefshme, diplomë, licensë profesionale individuale, CV, librezë pune dhe të listuar në listpagesat e Shoqërisë për periudhën e 3 (tre) muajve të fundit nga data e zhvillimit të procedurës:

- Minimumi 1(një) Inxhinier Hidroteknik
- Minimumi 1(një) Inxhinier Gjeodet/Topograf

- Minimumi 1(një) Projektues Elektrik

Shënim: Kjo kërkesë përmbushet nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 10 të DST. Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit ose nëse do të jetë nevoja për t'u kërkuar sqarime nga AK.

Stafi i angazhuar të paraqesë deklaratë disponueshmërie për kryerjen e shërbimeve që ka marrë përsipër të realizojë.

Në cdo rast AK ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik ose ti kërkojë operatorit ekonomik sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/ b), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë stafin, personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Njësia e prokurimit për vendosjen e stafit i është referuar Detyrës së Projektimit për këtë objekt pjesë e kësaj procedure, pjesë e secilave do të jenë të licensuar për shërbimet që priten të realizohen.

Më konkretisht, po paraqesim argumentimet për inxhinieret si më poshtë:

Inxhinieri Hidroteknik kërkohet për realizimin e shërbimeve të lidhura kryesisht me llogaritjet hidraulike për dimensionimin e tubacioneve të rrjetit të Kanalizimeve dhe sistemi i ujesjellesit , bazuar në modelimin e sistemit si dhe llogaritjet hidraulike të tubacioneve të shpërndarjes, pusetave HDPE , analizën e sistemit alternativën e përzgjedhur për të gjithë zonën e studimit, sipas kushteve teknike të projektimit.

Projektues Gjeodet/Topograf, kërkohet për realizimin e shërbimeve të lidhura kryesisht me rilevimin e kuotave gjeodezike, kordinative të rrugës dhe të gjithë hapësirës ku mendohet të kalojë sistemi i kanalizimeve dhe sistemi i ujesjellesit, percaktimi i vendodhjes së pusetave HDPE , gjurmët e linjave KUZ dhe kolektorit sekondar dhe primar drejt pikës fundore të trajtimit , të jepet plani i piketimit dhe verifikimi paraprak në terren për saktësinë e të dhënave përpara fillimit të projektit të zbatimit.

Projektues Inxhinier Elektrik , kërkohet për realizimin e shërbimeve të lidhura kryesisht me projektimin e punimeve elektrike në stacionin e pompimit si (transformatori, pajisje matje energjie , pajisje ndërprerje tensioni mesatar, punime ndricimi, linja të jashtme për furnizimin me energji të impiantit dhe Stacionit të Pompimit KUZ.

2.3.4 Operatori Ekonomik duhet të paraqesë Çertifikatat ISO, si më poshtë:

- Çertifikatat e cilësisë sipas Standartit **ISO 9001:2015 (për sistemin e menaxhimit të cilësisë vlefshme, Ne rast se oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh ky kriter plotësohet nga të gjithë anëtarët e BOE)**
- Çertifikatat e cilësisë sipas Standartit **ISO 14001:2015 / 14001: 2026 (për sistemin e menaxhimit të mjedisit), e vlefshme, Ne rast se oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh ky kriter plotësohet nga të gjithë anëtarët e BOE)**
- Çertifikatat e cilësisë sipas Standartit **ISO 45001-2018/ 45001: 2023 (për sistemin e menaxhimit të shëndetit dhe sigurisë në punë), ose certifikatën ekuivalente, e vlefshme, Ne rast se oferta**

Të gjitha certifikatat e mësipërme duhet të jenë të vlefshme të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

Nëse certifikatat janë në gjuhë të huaj, ato të paraqiten të përkthyer dhe të noterizuara në gjuhën zyrtare shqipe. Këto certifikata të jenë lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit i akredituar nga Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit ose nga organizmat ndërkombëtarë akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë. Certifikatat duhet të jenë të vlefshme në kohën e zhvillimit të tenderit. Në rast bashkimi të operatorëve ekonomikë, secili operator ekonomik duhet të dorëzojë certifikatat e mësiperme sipas natyrës së punimeve që do të marrë përsipër të realizojë, referuar kontratës së bashkëpunimit të nënshkruar.

Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më sipër, ose t'i kërkojë operatorit sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime, në përputhje me nenin 26, pika 7, të VKM nr.285, datë 19.05.2021, "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik.

Argumentim: Kërkesat e cilësisë të përcaktuara sipas pikës 2.3.13 janë vendosur në mbështetje të Ligjit Nr. 162/2020 "Për Prokurimin Publik" (i ndryshuar), Neni 79, pika 1 ku citohet se: "Autoriteti ose enti kontraktor për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t'u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë", si dhe në zbatim të Nenit 44, pika 1 dhe pika 3 të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", ku përcaktohet se: "Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t'u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit".

ISO 9001:2015 është një seri normash dhe standartizimesh ndërkombëtare, që i referohen sistemeve të menaxhimit të cilësisë, pra, të strukturave të organizimit të ndërmarrjeve publike dhe private, struktura të cilat këto ndërmarrje duhet t'i adoptojnë për një orientim më të mirë të ndërmarrjes në standartet e tregut. AK gjykon se çdo Ofertues duhet të jetë i pajisur me ISO 9001:2015 me qëllim efektivitetin dhe efektshmërinë në zhvillimin e veprimtarisë së tij, e cila do të sjellë dhe zvogëlimin e kostove. Pra ky certifikim do të bëjë të mundur që Ofertuesit të ofrojnë cilësi të mirë me çmime të ulta.

ISO 14001:2015 ofron një kuadër praktik për shoqëritë që duan të menaxhojnë rreziqet mjedisore ekzistuese dhe potenciale. Ky sistem integrohet lehtësisht në strukturën e menaxhimit të biznesit për të kontrolluar impaktet që aktivitetet, operacionet, produktet dhe shërbimet kanë mbi mjedisin. AK gjykon se çdo Ofertues duhet të jetë i pajisur me ISO 14001:2015 me qëllim që veprimtaria e ushtruar nga ana e tij (në rastin konkret realizimi i punës objekt prokurimi) të identifikojë impaktin në mjedis gjatë aktivitetit të saj si dhe të përmirësojë performancën mjedisore duke zbatuar një qasje sistematike. Pra ky certifikim do të bëjë të mundur që Ofertuesit të ushtrojnë veprimtarinë duke pasur në konsideratë parimin e mbrojtjes së mjedisit.

ISO 45001-2018/45001-2023 është standard ndërkombëtar, i cili parashtrohet kërkesat për menaxhimin e praktikave të mira të sigurisë dhe shëndetit në punë për çdo organizatë, pavarësisht nga madhësia. AK gjykon se çdo Ofertues duhet të jetë i pajisur me ISO 45001-2018 me qëllim që veprimtaria e ushtruar nga

ana tij (në rastin konkret realizimi i punës objekt prokurimi) të realizohet duke u mbështetur mbi parimin e sigurisë dhe shëndetit në punë. Kjo kërkesë shërben dhe si një garanci extra që do të sjellë reduktimin e aksidenteve dhe sëmundjeve në vendin e punës duke minimizuar kostot si dhe kohën në përmbushjen me sukses të kontratës së punës objekt prokurimi.

Në VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (e ndryshuar), Kreu XI, Neni 88, pika 3, cilësohet se: “Secili prej anëtarëve të këtij bashkimi duhet të përmbushë kërkesat e parashikuara në nenin 76 të LPP dhe ato të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Kërkesat për kualifikim ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në akt marrëveshje”.

Për sa më lart, Njësia e Prokurimit, gjykon se, kjo kërkesë në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik duhet të përmbushet nga Shoqëria e cila referuar Marrëveshjes së Bashkëpunimit ka marrë përsipër të realizojë zërat e parashikuara sipas Preventivit.

AK gjykon se kërkesa për pajisjen e Ofertuesve me Çertifikatat e kërkuara sipas pikës 2.3.4, është brenda kuadrit të parashikuar nga legjislacioni për prokurimin publik. Çertifikatat e kërkuara janë në përpjestim me objektin e kontratës dhe respektojnë natyrën e punimeve.

2.3.5 Operatori ekonomik duhet të ketë një punësimin mesatar jo më pak se **80 (tetëdhjetë) punonjës**, për periudhën **3 (tre)** muajt e fundit nga data e hapjes së ofertave, ku përfshihen edhe Stafi menaxherial i Drejtuesve Teknik. Për përmbushjen e këtij kushti, operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të deklarojë sipas formës së disponimit të punonjësve në seksionin përkatës të Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të shtojcës 8 në DST, dhe në rast se kualifikohet, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, duhet të paraqesë:

1. Vërtetim të lëshuar nga Administrata Tatimore ku të specifikohet numri i punonjësve për secilin muaj për periudhën e mësipërme.
2. Listëpagesat e Kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore të konfirmuara nëpërmjet formës elektronike nga organet tatimore për periudhën e mësipërme.

Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, ky kusht, plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit, në raport me përqindjen (elementët konkretë) e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar dhe nenit 39, pika 6/ç dhe 6/d, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë fuqinë minimale punëtore, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

Në përcaktimin e numrit të punonjësve specialisti i fushës ka bërë një analizë bazuar tek faktorët, si volumet dhe kategoritë e punimeve, kualifikimi i punonjësve, grafiku i punimeve, zërat e punimeve dhe orët e punës dhe pagën minimale të lejuar që duhen për të përmbushur kontratën. Numri i punonjësve dhe qëndrueshmëria e tyre në punë me kohështirje tre mujore nga data e zhvillimit të tenderit, tregon besueshmëri për autoritetin që, operatori do të përmbushë kontratën. Dëshmia e kërkuar për numrin e fuqisë punëtore të operatorit ekonomik e nevojshme për ekzekutimin e objektit të kontratës, është dokument që vërteton kapacitetin teknik dhe profesional të operatorit, përsa kohë janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës. Deklarimi dhe regjistrimi i punonjësve në regjistrin e sigurimeve është një detyrim ligjor i punëdhënësit e parashikuar nga Kodi

i Punës, për rrjedhojë vërtetimi i lëshuar nga administrata tatimore e shoqëruara me listpagesat me këtë kohështrirje është dokument vërtetues për qëndrueshmërinë e të punësuarve, përvojën e tyre, dhe janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës. Punësimi i një numri të caktuar, përveç besueshmërisë së operatorëve ekonomik, si një nga kërkesat themelore të kualifikimit, përpiqet të kufizojë edhe problematikat sociale dhe shmangien e informalitetit në tregun e punës. Po ashtu është një tregues i kualifikimit dhe eksperiencës që duhet të ketë kjo kategori e punonjësve. Vendosja e kriterit për një punësim të paktën 150 punonjës duke përfshirë dhe stafin teknik, është në përputhje me volumin e punës, natyrën e punimeve. Kriteri për kualifikim është vendosur që t'i shërbejë autoritetit për të njohur gjendjen e kapaciteteve të operatorëve të cilët nëpërmjet dokumentacionit të vërtetojnë se zotërojnë, kapacitetet teknike dhe profesionale, personelin e nevojshëm, si dhe kapacitetet organizative, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

Analizat teknike janë bazuar në VKM Nr. 216, datë 13.04.2023 “Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe të analizave teknike të tyre”. Bazuar në këto elementet e strukturës së kostos (material, puntori, makineri, transport).

(Numri i punonjësve, i mjeteve/makinerive që nevojiten për realizimin e kontratës është përcaktuar bazuar në ligjin Nr. 8402 datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar dhe akteve nënligjore)

Në mënyrë të përmbledhur numri i fuqisë puntorë që kërkohet për realizimin e punimeve është min 80 (tetëdhjetë) punonjës.

2.3.6 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojë stafin kryesor e mbështetës, punonjësit specialistë dhe certifikimet përkatëse, si më poshtë:

a) Operatorët ekonomik pjesëmarrës duhet të kenë në liçencë të shoqërisë e të punësuar në stafin e tij teknik për kryerjen e të gjitha punimeve në këtë objekt, të vërtetuar me kontratë noteriale pune (të vlefshme), diplomë përkatëse, CV, librezë pune, si dhe të figurojnë detyrimisht në listpagesat e shoqërisë për periudhën e kërkuar në pikën 2.3.6, stafi inxhinierik si më poshtë:

- Minimumi 1 (një) Inxhinier Ndërtimi
- Minimumi 1 (një) Inxhinier Hidroteknik
- Minimumi 1 (një) Inxhinier Mekanik
- Minimumi 1 (një) Inxhinier Gjeodet/Topograf/Markshajder
- Minimumi 1 (një) Inxhinier Elektrik
- Minimumi 1 (një) Inxhinier Mjedisi
- Minimumi 1 (një) Inxhinier Elektronik

Drejtuesit teknik duhet të jenë të punësuar sipas kriterëve të VKM – së 42, datë 16.01.2008, i ndryshuar për sa i takon ndalimeve të dypunësimit. Në çdo rast, Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të bëjë verifikime lidhur me deklaratimet e operatorit ekonomik në funksion të përmbushjes së këtij kriteri.

Për secilin pjesëtar të stafit inxhinierik të mësipërm Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të paraqesë: Kontratë pune e vlefshme gjatë gjithë kohës së zbatimit të punimeve objekt kontrate, Diplomë, Librezë pune dhe CV (Drejtuesit Teknik të jenë të siguruar sipas legjislacionit në fuqi).

**** Kriteri konsiderohet i përmbushur me vetëdeklarimin sipas Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës Nr 8. “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari dorëzimin e dokumenteve provuese. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njehsuara me origjinalin.*

Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, ky kusht, plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit, në raport me përqindjen (elementët konkretë) e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.

Argumentimi: AK argumenton se kjo kërkesë mbështetet në nenin 77, pika 4 të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar), si dhe në nenin 39, pika 6, gërma “c” të VKM-se Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (i ndryshuar).

Kriteri për stafin drejtues teknik, lidhet ngushtësisht me objektin e kontratës, relacionin teknik dhe zërat e punimeve. Nevoja për inxhinierët në objekt është e diktuar nga përvoja dhe legjislacioni për punimet e ndërtimit. Mungesa e këtij stafi pothuajse në çdo rast rezulton në realizim jashtë afatit, jashtë normave dhe me cilësi të dobët të objekteve. Numri i stafit kryesor teknik si numri i inxhinierëve të ndërtimit, etj është përcaktuar nga pikëpamja e natyrës teknike të kontratës me qëllimin për të patur një rezultat sa më të mirë në mbarëvajtjen dhe zbatimin e punimeve. Operatorët ekonomikë duhet të vërtetojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën. Drejtues teknik është përgjegjës për ndërtimin në përputhje me kushtet teknike të zbatimit, sigurimin teknik dhe mbrojtjen në punë brenda kushteve të kontratës. Bazuar në parashikimet e mësipërme të legjislacionit për prokurimin publik, Autoriteti Kontraktor ka kërkuar që operatori ekonomik ofertues duhet të ketë në stafin e tij **drejtues teknik** të cilët kanë një rol të rëndësishëm në mbarëvajtjen e punimeve pasi ata janë përgjegjës për zbatimin e objektit sipas projektit dhe në përputhje me kushtet teknike të zbatimit të tij.

Kërkesa specifike për Inxhinierët e kërkuar është përcaktuar në kuadër të analizës teknike që i është bërë Preventivit të Punimeve (nga ku përcaktohet qartazi dhe profili inxhinierik) si dhe në bashkrendim me kategoritë e kërkuara në Licencën profesionale të shoqërisë sipas pikës 2.3.2, kapaciteti teknik në DST. Duke marrë në konsideratë Projektin e zbatimit si dhe Preventivin e Punimeve rezulton se është e domosdoshme që çdo Ofertues të ketë pjesë të stafit Inxhinierë të kërkuar si me siper, të cilët në bashkëpunim me njëri tjetrin si dhe me fuqinë punëtore të shoqërisë do të realizojnë me sukses kontratën objekt prokurimi.

Lidhur me kërkesën që Drejtuesit Teknik të punimeve në objekt duhet të jenë të përfshirë në licencën e shoqërisë mbështetet në Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 42, datë 16.1.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”, pika 2 ku përcaktohet se: “Papajtueshmëritë me detyrën e drejtuesit teknik të shoqërisë së zbatimit Drejtuesit teknikë të shoqërisë nuk mund të jenë personat që janë të angazhuar në çdo punë-marrje tjetër publike. Drejtuesi teknik i shoqërisë nuk mund të jetë njëkohësisht i punësuar në dy apo më shumë shoqëri ndërtimi dhe ndalohet të disponojnë licencë për mbikëqyrje e kolaudim të punimeve të zbatimit” dhe pika 2: “elementët e licensës” gërma “c” ku citohet se: “Licencat e shoqërive jepen me afat të njëjtë me atë për të cilin janë regjistruar për të ushtruar veprimtari në QKB apo gjykatë. Ndalohet ushtrimi i veprimtarisë zbatuese në ndërtim në mungesë të drejtuesit/ve teknikë të shoqërisë. Shoqëritë e licencuara jo më vonë se 10 ditë kalendarike, kur drejtuesi teknik është dorëhequr ose ka pamundësi fizike për ushtrimin e detyrës (aksident, sëmundje me paaftësi ushtrimi detyre mbi 14 ditë, invaliditet, ndarje nga jeta), kanë detyrimin të paraqesin njoftim së bashku me kërkesën për drejtuesin e ri teknik të shoqërisë”.

Duke marrë në konsideratë Projektin e zbatimit si dhe Preventivin e Punimeve rezulton se është e domosdoshme që çdo Ofertues të ketë pjesë të stafit Inxhinierë të kërkuar, të cilët në bashkëpunim me njëri tjetrin, stafin mbështetës si dhe me fuqinë punëtore të shoqërisë do të realizojnë me sukses kontratën objekt prokurimi.

Minimumi 1 (një) Inxhinier Ndërtimi: Kërkohet për projektimin, organizimin, koordinimin dhe kontrollin e punimeve civile dhe strukturore të objektit. Impianti dhe rrjeti përfshijnë punime gërmimi, themele, struktura betonarme, puseta, ndërtesa dhe struktura ndihmëse, si dhe punime për sistemin dhe rehabilitimin e zonave të ndërhyrjes. Prania e këtij profili është e nevojshme për koordinimin teknik të punimeve të ndërtimit dhe realizimin e tyre në përputhje me projektin e miratuar.

Minimumi 1 (një) Inxhinier Hidroteknik: Përbën një nga profilet kryesore të objektit. Kërkohe për projektimin dhe zbatimin e rrjetit të kanalizimeve dhe komponentëve hidraulikë të impiantit, kryerjen dhe verifikimin e llogaritjeve hidraulike, përcaktimin e diametrave, prurjeve, kuotave dhe pjerrësive të tubacioneve, si dhe dimensionimin dhe kontrollin e elementeve hidroteknike të sistemit.

Minimumi 1 (një) Inxhinier Mekanik: Kërkohe për komponentët mekanikë dhe elektromekanikë të impiantit dhe rrjetit, përfshirë pompat, valvolat, tubacionet teknologjike, pajisjet mekanike dhe sistemet e tjera që do të përcaktohen nga zgjidhja teknologjike. Inxhinieri mekanik është i nevojshëm për përzgjedhjen, instalimin, kontrollin, testimin dhe vënien në funksion të pajisjeve mekanike.

Minimumi 1 (një) Inxhinier Gjeodet/Topograf: Kërkohe për rilevimet topografike dhe gjeodezike, përcaktimin e koordinatave dhe kuotave, piketimin e gjurmës së rrjetit dhe strukturave të impiantit, kontrollin gjatë zbatimit dhe hartimin e dokumentacionit përfundimtar “as-built”. Ky profil ka rëndësi të veçantë për rrjetin e kanalizimeve me gravitet, ku respektimi i kuotave dhe pjerrësive të projektimit ndikon drejtpërdrejt në funksionimin hidraulik të sistemit.

Minimumi 1 (një) Inxhinier Elektrik: Kërkohe për projektimin, realizimin dhe kontrollin e sistemeve të furnizimit dhe shpërndarjes së energjisë elektrike të impiantit, instalimeve elektrike, paneleve, mbrojtjeve, kabllimeve, ndriçimit dhe furnizimit të pajisjeve elektromekanike. Funksionimi i impiantit dhe i stacioneve të pompimit, kur parashikohen, është i lidhur drejtpërdrejt me furnizimin dhe instalimet elektrike.

Minimumi 1 (një) Inxhinier Mjedisi: Kërkohe për shkak të natyrës mjedisore të objektit, që ka si qëllim trajtimin e ujërave të ndotura dhe reduktimin e ndikimit të tyre në mjedis. Ky profil është i nevojshëm për trajtimin e çështjeve që lidhen me performancën mjedisore të impiantit, menaxhimin e ndikimeve gjatë zbatimit, shkarkimet, mbetjet/nënproduktet e procesit të trajtimit dhe respektimin e kërkesave mjedisore të zbatueshme për objektin.

Minimumi 1 (një) Inxhinier Elektronik: Kërkohe për projektimin, integrimin, programimin dhe vënien në funksion të sistemeve të komandimit, kontrollit dhe monitorimit të impiantit. Impiantet e trajtimit të ujërave të ndotura përmbajnë pajisje dhe procese që kërkojnë monitorim dhe komandim të parametrave të punës, instrumente matëse, sensorë, sisteme kontrolli dhe, sipas zgjidhjes së projektimit, sisteme PLC/SCADA.

Ky profil siguron mbulimin e komponentit të automatizimit dhe kontrollit të proceseve teknologjike të impiantit.

b) Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojë edhe stafin tjetër inxhinierik (jo domosdoshmërisht drejtues teknik në licencën e shoqërisë), të cilët të figurojnë në listëpagesa për të paktën 3 (tre) muajt e fundit, nga data e hapjes së procedurës, si më poshtë:

- Minimumi 1 (një) Inxhinier Hidroteknik
- Minimumi 1 (një) Inxhinier Ndërtimi profili Infrastruktura e transportit.
- Minimumi 1 (një) Inxhinier Ndërtimi profili Strukturist.
- Minimumi 1 (një) Inxhinier Gjeodet/Topograf/Markshajder

- Minimumi 1 (një) Inxhinier i specializuar per testim e performances se produkteve te ndertimit.

Per punojesit e mesiperm duhet te paraqiten:

- Kontratat e punës individuale (të vlefshme).
- Certifikata/diploma për formimin profesional (të vlefshme), të cilat duhet të jenë të lëshuara nga institucione publike/private të licensuara sipas ligjit Nr. 15/2017 “Për arsimin dhe formimin profesional në R.Sh.”, i ndryshuar.
- Per punonjesit teknik/ndertimi/topograf diplome të shkollës së mesme profesionale
- Te gjithë punojësit e mësipërm duhet të figurojnë ne listepagesat të shoqërisë minimalisht per periudhen 3 mujore.
- Në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, Deklarata B, operatorët ekonomik duhet të deklarojnë per punonjesit e mesiperm , emer/mbiemer, profili i punes, numri dhe datë e kontratës individuale të punës, numrin e amazes dhe titullin e kualifikimit per diplomën/certifikaten përkatëse si dhe emrin e institucionit qe ka leshuar dokumentin per specialistet e kualifikuar me siper.

Diplomat/certifikatat e paraqitura nga organizma të cilat nuk janë të licencuara sipas legjislacionit në fuqi do të konsiderohen si dokumenta të rreme të cilat përbëjnë shkak për skualifikim dhe/ose përjashtimin nga pjesëmarrja në prokurimet publike.

*Kriteri konsiderohet i përmbushur me paraqitjen e formularit të vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 8. Në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas deklarata B.

Argumentimi: AK argumenton se kërkesa për stafin inxhinierik është vendosur sipas përcaktimeve të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, Neni 77, pika 4, si dhe në VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar Kreu V, Seksioni III, Neni 39, pika 6, germa “c”.

Kriteri për stafin e mësipërm, lidhet ngushtësisht me objektin e kontratës, relacionin teknik dhe zërat e punimeve. Nevoja për inxhinierët në objekt është e diktuar nga përvoja dhe legjislacioni për punimet e ndërtimit. Mungesa e këtij stafi pothuajse në çdo rast rezulton në realizim jashtë afatit, jashtë normave dhe me cilësi të dobët të objekteve. Numri i stafit kryesor teknik si numri i inxhinierëve të ndërtim, hidroteknik, etj është përcaktuar nga pikëpamja e natyrës teknike të kontratës me qëllimin për të patur një rezultat sa më të mirë në mbarëvajtjen dhe zbatimin e punimeve. Operatorët ekonomikë duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën

Kërkesa specifike për Inxhinierët e kërkuar jo domosdoshmërisht të përfshirë në liçensën e shoqërisë është përcaktuar në kuadër të analizës teknike që i është bërë Preventivit të Punimeve (nga ku përcaktohet qartazi dhe profili inxhinierik) si dhe në bashkrendim me kategoritë e kërkuara në Liçencën profesionale të shoqërisë sipas pikës 2, kapaciteti teknik në DST. Duke marrë në konsideratë Projektin e zbatimit si dhe Preventivin e Punimeve rezulton se është e domosdoshme që çdo Ofertues të ketë pjesë të stafit Inxhinierë të kërkuar si me siper, të cilët në bashkëpunim me njëri tjetrin si dhe me fuqinë punëtore të shoqërisë do të realizojnë me sukses kontratën objekt prokurimi.

Minimumi 1 (një) Inxhinier Hidroteknik: Kërkesa për këtë profil lidhet drejtpërdrejt me objektin e kontratës, i cili përfshin projektimin dhe ndërtimin e rrjetit të kanalizimeve dhe të impiantit të trajtimit të ujërave të ndotura. Inxhinieri hidroteknik është i nevojshëm për hartimin dhe verifikimin e zgjidhjeve hidraulike të sistemit, përcaktimin e prurjeve

projektuese, dimensionimin e tubacioneve, përcaktimin e kuotave dhe pjerrësive, dimensionimin e elementeve të rrjetit dhe koordinimin e komponentëve hidroteknikë të impiantit.

Për shkak të natyrës “Projektim–Zbatim” të kontratës, ky profil është i nevojshëm si në fazën e projektimit, ashtu edhe gjatë zbatimit dhe verifikimit të zgjidhjeve të projektuara në terren.

Minimumi 1 (një) Inxhinier Ndërtimi – Profili Infrastrukturë Transporti: Kërkesa për këtë profil lidhet me ndërhyrjet që ndërtimi i rrjetit të kanalizimeve mund të shkaktojë në infrastrukturën rrugore ekzistuese dhe me nevojën për rehabilitimin e sipërfaqeve të prekura nga punimet.

Në segmentet ku tubacionet vendosen në trupin ose përgjatë rrugëve, realizimi i punimeve mund të kërkojë prerjen dhe heqjen e shtresave ekzistuese, rikonstruksionin e nënshtresave, ngjeshjen dhe rivendosjen e shtresave rrugore. Gjithashtu, objekti mund të përfshijë realizimin e rrugëve dhe shesheve të brendshme të impiantit.

Inxhinieri i profilit Infrastrukturë Transporti është i nevojshëm për projektimin dhe kontrollin teknik të këtyre ndërhyrjeve dhe për rikthimin e infrastrukturës së prekur në parametrat e kërkuar.

Minimumi 1 (një) Inxhinier Ndërtimi – Profili Strukturist: Kërkesa për këtë profil lidhet me projektimin dhe realizimin e strukturave të impiantit të trajtimit të ujërave të ndotura.

Në varësi të zgjidhjes teknologjike, impianti mund të përmbajë rezervuarë/basene, struktura betonarme, themele dhe bazamente për pajisjet teknologjike, godina teknike, puseta dhe struktura të tjera mbajtëse.

Inxhinieri strukturist është i nevojshëm për dimensionimin dhe verifikimin e elementeve strukturore, për kontrollin e qëndrueshmërisë dhe sigurisë së tyre dhe për ndjekjen teknike të realizimit të punimeve strukturore sipas projektit të miratuar.

Minimumi 1 (një) Inxhinier Gjeodet/Topograf: Kërkesa për këtë profil lidhet me nevojën për realizimin e punimeve topografike dhe gjeodezike gjatë projektimit dhe zbatimit të objektit.

Specialisti do të jetë i nevojshëm për rilevimin e gjendjes ekzistuese, përcaktimin e koordinatave dhe kuotave, piktimin e gjurmës së rrjetit dhe strukturave të impiantit, kontrollin e kuotave dhe pjerrësive gjatë realizimit të punimeve dhe përgatitjen e dokumentacionit përfundimtar “as-built”. Rëndësia e këtij profili është veçanërisht e lartë për rrjetet e kanalizimeve me gravitet, ku respektimi i kuotave dhe pjerrësive të projektimit është kusht për funksionimin e duhur hidraulik të sistemit.

Minimumi 1 (një) specialist për kontrollin/testimin e produkteve dhe materialeve të ndërtimit: Kërkesa për këtë specialist lidhet me nevojën për kontrollin e cilësisë së materialeve dhe produkteve që do të përdoren gjatë realizimit të veprës, si betoni, materialet e mbushjes dhe të shtresave, si dhe produkte të tjera ndërtimi që do të përcaktohen nga projekti i zbatimit.

Kontrolli dhe testimi shërbejnë për verifikimin e përputhshmërisë së materialeve dhe produkteve të përdorura me kërkesat teknike të projektit, specifikimet teknike dhe standardet e aplikueshme.

Duke qenë se kontrata është e tipit “Projektim–Zbatim”, llojet dhe sasi të përfundimtare të materialeve do të përcaktohen nga projekti i zbatimit. Për këtë arsye, kërkesa për specialistin duhet të lidhet me kontrollin e cilësisë dhe testimet që do të rezultojnë të nevojshme gjatë realizimit të veprës.

c) Operatori ekonomik duhet të disponojë punonjës të specializuar/të kualifikuar për kryerjen e punimeve, si më poshtë:

- Minimumi 2 (dy) Teknik Ndërtimi	Diplomë të shkollës mesme
- Minimumi 1 (një) Teknik Topograf	Diplomë të shkollës mesme
- Minimumi 1 (një) Teknik Mekanik	Diplome te shkolles mesme
- Minimumi 4 (një) Hekurkthyes	Çertifikatë trajnimi/DëshmiProfesionale
- Minimumi 4 (kater) Karpentierë	Çertifikatë trajnimi/DëshmiProfesionale
- Minimumi 1 (një) Hidroizolues	Çertifikatë trajnimi/DëshmiProfesionale
- Minimumi 1 (një) Murator	Çertifikatë trajnimi/Dëshmi Profesionale
- Minimumi 2 (dy) Suvatues	Çertifikatë trajnimi/Dëshmi Profesionale
- Minimumi 2 (dy) Pllakashtrues	Çertifikatë trajnimi/Dëshmi Profesionale
- Minimumi 3 (tre) Betonues	Çertifikatë trajnimi/Dëshmi Profesionale
- Minimumi 2 (dy) Saldator	Çertifikatë trajnimi/DëshmiProfesionale
- Minimumi 2 (dy) Elektricitist	Çertifikatë trajnimi/DëshmiProfesionale
- Minimumi 5 (pese) Hidraulik	Çertifikatë trajnimi/Dëshmi Profesionale
- Minimumi 5 (pese) Punëtorë për punime në rrugë dhe asfaltim /specialistë për punime në rrugë	Çertifikatë trajnimi/Dëshmi Profesionale

Per punojesit e mesiperm duhet te paraqiten:

- Kontratat e punës individuale (të vlefshme).
- Certifikata/diploma për formimin profesional (të vlefshme), të cilat duhet të jenë të lëshuara nga institucione publike/private të licensuara sipas ligjit Nr. 15/2017 “Për arsimin dhe formimin profesional në R.Sh.”, i ndryshuar.
- Per punonjesit teknik/ndertimi/topograf diplome të shkollës së mesme profesionale
- Te gjithë punojësit e mësipërm duhet të figurojnë në listepagesat të shoqërisë minimalisht për periudhën 3 mujore.
- Në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, Deklarata B, operatorët ekonomik duhet të deklarojnë për punonjesit e mesiperm , emer/mbiemer, profili i punes, numri dhe datë e kontratës individuale të punës, numrin e amazes dhe titullin e kualifikimit për diplomën/certifikatën përkatëse si dhe emrin e institucionit që ka lëshuar dokumentin për specialistet e kualifikuar me sipër.

Diplomat/certifikatat e paraqitura nga organizma të cilat nuk janë të licencuara sipas legjislacionit në fuqi do të konsiderohen si dokumenta të rreme të cilat përbëjnë shkak për skualifikim dhe/ose përjashtimin nga pjesëmarrja në prokurimet publike.

*Kriteri konsiderohet i përmbushur me paraqitjen e formularit të vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 8. Në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas deklarata B.

Argumentimi: Kjo kërkesë mbështetet në Ligjin Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, Neni 77, pika 4, si dhe në VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Kreu V, Seksioni III, Neni 39, pika 6, gërma “ç”. Qëllimi i vendosjes së këtij kushti është i implementuar sipas dispozitave ligjore dhe shërben si një garanci që kontrata objekt prokurimi do të realizohet me sukses sipas

Specifikimeve Teknike (të cilat do publikohen së bashku me Dokumentat e Tenderit) si dhe punimet do të kryhen brenda afatit kohor të parashikuar në Njoftimin e Kontratës. Sqarojmë se, të gjithë specialistët e kërkuar janë në përputhje të plotë me projekt-preventivin duke marrë në konsideratë volumet e punes që do të realizohen, si dhe kohëzgjatjen e tyre. Autoriteti Kontraktor domosdoshmërisht duhet të garantojë që këto punime do të kryhen nga persona të kualifikuar dhe me eksperiencë të mjaftueshme, për zbatimin e këtyre punimeve sipas standarteve të percaktuara në specifikimet teknike. Zbatimi i punimeve që përfshijnë projektin duhet të kryhet nga fuqi punëtore e kualifikuar për secilën tipologji punimesh. Për të vërtetuar kualifikimin e stafit teknik është kërkuar që të jenë të pajisur me dokument që të vërtetojë kualifikimin profesional (dëshmi kualifikimi profesional/ certifikatë/diplomë), lëshuar nga institucione (shtetërore apo private) të licencuara/akredituara nga autoritetet përgjegjëse shtetërore, sipas ligjit nr. 15/2017 “Për arsimin dhe formimin profesional në R.Sh.”. Mbështetur në këtë legjislacion certifikimet profesionale ofrohen nga institucione të licencuara nga Ministria përkatëse nëpërmjet Agjencisë Kombëtare të Arsimit, Formimit Profesional. Përcaktimi i numrit të punonjësve dhe profesionet është bazuar mbi zërat dhe volumet e punes si dhe afateve për perfundimin e punimeve, në mbështetje të të cilave janë bazuar në VKM nr. 216, datë 13.4.2023 “Për krijimin dhe funksionimin e sistemit të integruar përinformatizimin e manualit të çmimeve për zërat e punimeve në ndërtim”. Bazuar në këto elemente të strukturës së kostos (material, puntori, makineri, transport). Numri i punonjësve, dhe profesionet që nevojiten për realizimin e kontratës është përcaktuar bazuar në ligjin Nr. 8402 datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar dhe akteve nëligjore. Personeli i mësipërm kërkohet në bazë të vlerësimit të projektit idesë dhe preventivit, grafikut të punimeve.

Minimumi 2 (dy) Teknikë Ndërtimi – Diplomë e shkollës së mesme profesionale: Kërkohet për ndjekjen e përditshme të punimeve civile në kantier, kontrollin e zbatimit sipas projektit, organizimin e fronteve të punës, kontrollin e materialeve dhe koordinimin e punonjësve të specializuar. Kërkesa për 2 teknikë lidhet me natyrën e objektit, i cili përfshin dy komponentë kryesorë: impiantin dhe rrjetin e kanalizimeve.

Minimumi 1 (një) Teknik Topograf – Diplomë e shkollës së mesme profesionale: Kërkohet për mbështetjen e punimeve topografike gjatë zbatimit, përfshirë piktimin, kontrollin e kuotave, akteve dhe pjerrësive të tubacioneve dhe strukturave. Ky funksion është veçanërisht i rëndësishëm për rrjetin e kanalizimeve me gravitet.

Minimumi 1 (një) Teknik Mekanik – Diplomë e shkollës së mesme profesionale: Kërkohet për mbështetjen teknike gjatë montimit, instalimit dhe kontrollit të pajisjeve mekanike dhe elektromekanike të impiantit, tubacioneve teknologjike, pompave, valvolave dhe pajisjeve ndihmëse.

Minimumi 4 (katër) Hekurkthyes – Certifikatë trajnimit/Dëshmi profesionale: Kërkohet për përgatitjen, prerjen, kthimin dhe montimin e armaturës së çelikut për strukturat betonarme të impiantit, bazamentet, pusetat dhe strukturat e tjera që do të realizohen. Numri prej 4 punonjësish mundëson formimin e një grupi pune për realizimin e punimeve të armimit.

Minimumi 4 (katër) Karpentierë – Certifikatë trajnimit/Dëshmi profesionale: Kërkohet për realizimin dhe montimin e kallëpeve të strukturave prej betoni dhe betonarmeje. Punimet e impiantit mund të përfshijnë rezervuarë, basene, mure, soleta, themele dhe struktura të tjera që kërkojnë punime kallëpesh. Numri prej 4 punonjësish përbën një grup minimal pune për këto procese.

Minimumi 1 (një) Hidroizolues – Certifikatë trajnimit/Dëshmi profesionale: Kërkohet për realizimin e hidroizolimit të strukturave që janë në kontakt me ujë, ujërat e ndotura ose lagështinë. Ky proces është veçanërisht i rëndësishëm për rezervuarët, basenet dhe strukturat nëntokësore të impiantit, ku kërkohet kontrolli i infiltrimeve dhe rrjedhjeve.

Minimumi 1 (një) Murator – Certifikatë trajnimi/Dëshmi profesionale: Kërkohet nëse objekti përfshin realizimin e godinave teknike, ambienteve të shërbimit ose elementeve të tjera murature në impiant. Nevoja për këtë profil lidhet me punimet arkitektonike dhe civile të këtyre objekteve.

Minimumi 2 (dy) Suvatues – Certifikatë trajnimi/Dëshmi profesionale: Kërkohen për realizimin e punimeve të suvatimit dhe përfundimit të sipërfaqeve të godinave dhe ambienteve teknike të impiantit, nëse këto punime parashikohen nga kërkesat e objektit.

Minimumi 2 (dy) Pllakashtrues – Certifikatë trajnimi/Dëshmi profesionale: Kërkohen për realizimin e veshjeve dhe shtresave përfundimtare në ambientet e impiantit ku, për arsye funksionale, higjienike ose mirëmbajtjeje, parashikohet përdorimi i pllakave. Kjo kërkesë duhet të mbahet vetëm nëse punime të tilla parashikohen nga kërkesat funksionale të objektit.

Minimumi 3 (tre) Betonues – Certifikatë trajnimi/Dëshmi profesionale: Kërkohen për hedhjen, përpunimin, vibrimin dhe trajtimin e betonit gjatë realizimit të strukturave të impiantit, pusetave, bazamenteve dhe elementeve të tjera betonarme. Numri prej 3 punonjësish konsiderohet një ekip minimal për realizimin e këtij procesi.

Minimumi 2 (dy) Saldatorë – Certifikatë trajnimi/Dëshmi profesionale: Kërkohen për punimet e saldimit që lidhen me strukturat dhe elementet metalike, tubacionet teknologjike dhe komponentët mekanikë të impiantit, sipas materialeve dhe teknologjisë që do të përcaktojë projekti i zbatimit.

Minimumi 2 (dy) Elektricitë – Certifikatë trajnimi/Dëshmi profesionale: Kërkohen për realizimin e instalimeve elektrike, shtrimin dhe lidhjen e kablllove, instalimin e pajisjeve dhe paneleve dhe lidhjen elektrike të komponentëve elektromekanikë të impiantit. Numri prej 2 punonjësish mundëson krijimin e një grupi minimal për realizimin e punimeve elektrike.

Minimumi 5 (pesë) Hidraulikë – Certifikatë trajnimi/Dëshmi profesionale: Kërkohen për montimin dhe instalimin e tubacioneve, rakorderive, valvolave dhe elementeve të tjera të rrjetit të kanalizimeve dhe sistemeve hidraulike/teknologjike të impiantit.

Duke qenë se vendosja dhe montimi i tubacioneve përbën një nga proceset kryesore të objektit, kërkesa për një grup prej 5 punonjësish synon të sigurojë kapacitetin minimal për organizimin e një fronti pune për montimin e tubacioneve dhe elementeve përkatëse.

Minimumi 5 (pesë) punonjës të specializuar për punime rrugore dhe asfaltim – Certifikatë trajnimi/Dëshmi profesionale: Kërkohen për realizimin e punimeve të rehabilitimit të sipërfaqeve rrugore të prekura nga hapja e kanaleve të rrjetit të kanalizimeve, përfshirë përgatitjen e shtresave, sistemimin, ngjeshjen dhe punimet e asfaltimit.

Kërkesa për 5 punonjës synon të sigurojë një grup minimal pune për realizimin e këtyre proceseve, në rastet kur gjurma e rrjetit ndërhyr në infrastrukturën rrugore ekzistuese.

- a) **Minimumi 1 (një) punonjës** të pajisur me certifikate lëshuar nga Ministria e Mjedisit “*Për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis*” në përputhje me klauzolat e Ligjit Nr. 10 440, datë 7.7. 2011 “Për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis” të vërtetuar me kontratë pune të vlefshme, Diplome/certifikate.

Argumentimi: Kërkesa për disponimin e minimumi 1 (një) specialisti/eksperti të kualifikuar në fushën e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis (VNM) lidhet me natyrën dhe karakteristikat e objektit të kontratës, i cili përfshin projektimin dhe zbatimin e një impianti për trajtimin e ujërave të ndotura dhe të rrjetit të kanalizimeve.

Realizimi i një infrastrukture të kësaj natyre lidhet drejtpërdrejt me çështje mjedisore, si menaxhimi dhe trajtimi i ujërave të ndotura, shkarkimet e trajtuara, menaxhimi i llumrave dhe mbetjeve që gjenerohen nga procesi, ndikimet e mundshme në tokë dhe ujë, si dhe ndikimet që mund të krijohen gjatë fazës së ndërtimit dhe vënies në funksion të veprës.

Duke qenë se kontrata është e tipit **“Projektim–Zbatim”**, gjatë zhvillimit të projektit duhet të merren në konsideratë kërkesat mjedisore të zbatueshme dhe masat e nevojshme për parandalimin, reduktimin dhe menaxhimin e ndikimeve të mundshme në mjedis.

Përfshirja e një specialisti të kualifikuar në fushën e VNM-së synon të sigurojë kapacitetin profesional të operatorit ekonomik për trajtimin e çështjeve mjedisore që lidhen me projektimin dhe zbatimin e veprës dhe, sipas rastit, për përgatitjen dhe/ose mbështetjen e dokumentacionit mjedisor të kërkuar nga legjislacioni në fuqi.

Kërkesa për minimumi **1 (një) specialist** konsiderohet proporcionale me natyrën dhe kompleksitetin mjedisor të objektit të kontratës.

- b) Operatori/et ekonomik duhet të ketë në stafin e tij minimum 1 (një) punonjës specialist **“Ekspert Zjarrefikës ne fushën e mbrojtjes nga Zjarri dhe për shpëtim”** në përputhje me Ligjin Nr. 152/2015 "Për shërbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe për shpëtimin", shoqëruar me kontratë individuale pune të vlefshme, Diplomë/Certifikatë dhënë nga Drejtoria MZSH, si dhe të figurojë në listëpagesat e shoqërisë minimumi per periudhën e fundit të deklaruar nga data e hapjes se ofertave ose me marrdhënie kontraktore/kontratë (të noterizuar) me qëllim ekzekutimin e kontratës objekt prokurimi .

**** Kriteri konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës Nr. 8. “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese”. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njehsuara me origjinalin.*

Argumentimi: AK argumenton se kërkesa për “Ekspert Zjarrefikes ne fushen e mbrojtjes nga Zjarri dhe per shpetim” është vendosur sipas përcaktimeve të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, Neni 77, pika 4; të VKM-së Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Kreu V, Seksioni III, Neni 39, pika 6, gërma “c”, si dhe në mbështetje të Nenit 49, pika 4 të Ligjit Nr. 152/2015, “Për shërbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe per shpetimin“, ku citohet se : “Drejtoria e Përgjithshme e MZSH-së jep certifikatë për personat fizikë e juridikë për ushtrimin e aktivitetit të ekspertit zjarrefikës privat, në bazë të kriterëve të veçanta të miratuara me udhëzim të ministrit”.

Theksojmë se, për shkak të natyrës së punimeve që kryhen: punime elektrike, saldimi etj të cilat kanë potencial të shkaktimit të aksidenteve me rrezik zjarri kërkohet një specialist për të bërë planin e masave dhe evakuimin në raste aksidentesh ndaj zjarrit prandaj shihet e nevojshme dhe e domozdoshme prania e **1 (një) specialist Ekspert Zjarrefikes ne fushen e mbrojtjes nga zjarri dhe per shpetimin.**

- c) Operatori/et ekonomik duhet të kenë në stafin e tij personel të kualifikuar/çertifikuar minimumi 1 (një) punonjës me çertifikatë **“Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë”** në përputhje me klauzolat e Ligjit Nr. 10237 datë 18/02/2010 "Për sigurinë dhe shëndetin në punë" dhe VKM Nr. 312, date 05.05.2010 "Për miratimin e rregullores "Për sigurinë në kantier", shoqëruar me kontratë individuale pune të vlefshme, Diplomë/Certifikatë, si dhe të figurojë në

listëpagesat e shoqërisë minimumi për periudhën e fundit të deklaruar nga data e hapjes së ofertave.

Kriteri konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës Nr. 8. “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese”. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njehsuara me origjinalin.

Autoriteti Kontraktor argumenton se kërkesa për “Përgjegjësin për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë” është vendosur sipas përcaktimeve të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, Neni 77, pika 4; të VKM-së Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Kreu V, Seksioni III, Neni 39, pika 6, gërma “c”, si dhe në mbështetje të Nenit 7 të Ligjit Nr. 10237, datë 18.02.2010, “Për sigurinë dhe shëndetin në punë”, sipas të cilit: „Punëdhënësi ngarkon një ose disa punëmarës që të merren me çështjet e mbrojtjes, të sigurisë e shëndetit në punë.....“.

Kërkesa për disponimin e përgjegjësit për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë sipas çertifikimit përkatës shmanë dhe parandalon çdo rrezik që mund të shfaqet gjatë veprimtarisë së shoqërisë në kantier dhe që mund të çënojë shëndetin apo sigurinë e stafit në kantier. Në këto kushte, vendosja e këtij kriteri është e domosdoshme pasi shërben si garanci që ofertuesit do të realizojnë punimet në përputhje me standartet ligjore në fuqi. Funkcioni i përgjegjësit për sigurinë dhe mbrojtjen në punë ka karakter parandalues dhe mbikëqyrës. Ai përfshin identifikimin dhe vlerësimin e rreziqeve në vendin e punës, hartimin dhe zbatimin e masave parandaluese, monitorimin e respektimit të rregullave të sigurisë, si dhe këshillimin e punëdhënësit për përmbushjen e detyrimeve ligjore në fushën e sigurisë dhe shëndetit në punë

- d) Operatori/et ekonomik duhet të kenë në stafin e tij personel të kualifikuar/çertifikuar minimumi 1 (një) punonjes i pajisur me çertifikate **“Ekspert për ndihmën e parë dhe ndërhyrjen ndaj emergjencave”** e cila të jetë e lëshuar nga shoqëri të akredituara ose nga organizma ndërkombëtare akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë, shoqëruar me kontratë individuale pune të vlefshme, Diplome/certifikate, si dhe të figurojë në listëpagesat e shoqërisë minimumi për periudhën e fundit të deklaruar nga data e hapjes së ofertave.

Kriteri konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës Nr. 8. “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese”. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njehsuara me origjinalin.

Argumentimi : Ky kriter është hartuar në përputhje me përcaktimet e Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, Neni 77, pika 4; të VKM-së Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Kreu V, Seksioni III, Neni 39, pika 6, gërma “c”, si dhe në mbështetje të Nenit 8, të Ligjit Nr. 10237, datë 18.02.2010, “Për sigurinë dhe shëndetin në punë”, sipas të cilit: „Punëdhënësi merr masa paraprake për të organizuar dhënien e ndihmës së parë,.....“. Kërkesa për disponimin e ekspertit të ndihmës së parë dhe ndërhyrjes në emergjencë gjatë proceseve të ndërtimit në kantier është i rëndësishëm pasi ndikon në mënyrë të drejtëpërdrejtë në dhënien e ndihmës së parë në rast aksidentesh në vendin e punës, ul rrezikun e pasojave ndaj jetës dhe shëndetit të punonjësve, në rast aksidenti, në kantier. Në këto kushte, është kusht ligjor vendosja e këtij kriteri pasi shërben si garanci që ofertuesit do të realizojnë punimet në përputhje me standartet ligjore në fuqi

“Përgjegjësi për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë” rekomandohet të jete në kantier për trajnimin e punonjësve të kantierit për minimizimin e aksidenteve në punë.

- e) Kandidati ofertues duhet të përcaktojë me anë të një deklarate (nga Administratori i shoqërisë) Drejtuesin Teknik të punimeve në objekt i cili duhet të jetë i përfshirë në liçencën e shoqërisë, dhe të deklarojë se do të jetë i pranishëm gjatë gjithë kohës që do të kryhen punimet në objekt, ku në rast se kualifikohet, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, për drejtuesin teknik të deklaruar, duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:
- Librezë pune (përkatëse)
 - CV përkatëse
 - Kontratë noteriale pune e vlefshme (përkatëse)
 - Diplomë

Në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomik, secili operator ekonomik në bashkim, duhet të përcaktojë me anë të një deklarate, Drejtuesin Teknik të punimeve në objekt, i cili duhet të jetë i përfshirë në liçencën e shoqërisë dhe të deklarojë se do të jetë i pranishëm gjatë gjithë kohës që do të kryhen punimet në objekt në varësi të vlerës së preventivit të punimeve që ka marrë përsipër sipas përqindjes së bashkëpunimit.

Argumentimi: Kjo kërkesë mbështetet në nenin 77, pika 4 të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar), si dhe në nenin 39, pika 6, gërma “c” të VKM-se Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (i ndryshuar).

Duke qenë se objekt prokurimi është kontratë pune, sqarojmë se detyrimin për prezencën e Drejtuesit Teknik gjatë gjithë kohës që do të kryhen punimet në objekt e përcakton qartazi Udhëzimi Nr. 2, datë 13.05.2005 “Për zbatimin e punimeve të ndërtimit”, konkretisht pika 1.2 ku citohet se: “drejtuesit ligjore dhe teknik të sipërmarrësit janë përgjegjës përpara investitorit për ndërtimin e veprës, sipas projektit, për kryerjen e punimeve të ndërtimit, në përputhje me kushtet teknike të zbatimit, specifikimet teknike, sigurimin teknik dhe mbrojtjen në punë, brenda kushteve të kontratës e dispozitave ligjore në fuqi” si dhe pikës 2.1 ku citohet se “drejtimi teknik i punimeve në kantier sigurohet, sipas rastit, drejtpërdrejtë nga drejtuesi teknik i sipërmarrësit ose përgjegjësi teknik i kantierit.

Lidhur me kërkesën që Drejtuesi Teknik i punimeve në objekt duhet të jetë i përfshirë në liçencën e shoqërisë dhe të mos jetë i angazhuar në kontrata të tjera, mbështetet në Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 42, datë 16.1.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”, pika 2 ku përcaktohet se: “Papaftueshmëritë me detyrën e drejtuesit teknik të shoqërisë së zbatimit Drejtuesit teknikë të shoqërisë nuk mund të jenë personat që janë të angazhuar në çdo punë-marrje tjetër publike. Drejtuesi teknik i shoqërisë nuk mund të jetë njëkohësisht i punësuar në dy apo më shumë shoqëri ndërtimi dhe ndalohej të disponojnë liçencë për mbikëqyrje e kolaudim të punimeve të zbatimit” dhe pika 2: “elementët e liçensës” gërma “c” ku citohet se: “Licencat e shoqërive jepen me afat të njëjtë me atë për të cilin janë regjistruar për të ushtruar veprimtari në QKR apo gjykatë. Ndalohej ushtrimi i veprimtarisë zbatuese në ndërtim në mungesë të drejtuesit/ve teknikë të shoqërisë. Shoqëritë e licencuara jo më vonë se 10 ditë kalendarike, kur drejtuesi teknik është dorëhequr ose ka pamundësi fizike për ushtrimin e detyrës (aksident, sëmundje me paafësi ushtrimi detyre mbi 14 ditë, invaliditet, ndarje nga jeta), kanë detyrimin të paraqesin njoftim së bashku me kërkesën për drejtuesin e ri teknik të shoqërisë”.

Për sa më lart, çdo kërkesë e renditur për Drejtuesin Teknik, buron nga kontrata e punës objekt prokurimi, me qëllim përmbushjen dhe realizimin e saj sipas kushteve dhe dispozitave ligjore në fuqi.

2.3.7 Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të deklarojë në seksionin përkatës të Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit sipas shtojcës 8 në DST, se ka pjesë të stafit të punësuar:

- | | |
|----------------------------|--------------------------|
| - Manovrator Eskavatoristë | jo më pak se 5 (pesë) |
| - Manovrator Automakinistë | jo më pak se 4 (katër) |
| - Manovrator Buldozeristë | jo më pak se 1 (një) |
| - Shoferë | jo më pak se 6 (gjashtë) |

,të cilët duhet të figurojnë në listëpagesa të shoqërisë të punësuar për periudhën e kërkuar në pikën 2.3.6 në rastin kur mjetet/ makineritë e deklaruar janë në pronësi të operatorit ekonomik ofertues, në të kundërt kur mjetet/ makineritë disponohen me qera, ky staf i kërkuar mund të jetë i kontraktuar, **dhe në çdo rast, në rast se kualifikohet, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, për secilin të paraqiten:**

Per punojesit e mesiperm duhet te paraqiten:

- Kontratat e punës individuale të vlefshme.
- (Dëshmi te Aftësisë Profesionale), që të vërtetojë kualifikimin profesional të kërkuar, referuar rregullores “Për kushtet, kriteret dhe programet për përgatitjen teoriko-praktike të kandidatëve, si dhe dhënien e Dëshmisë së Aftësisë Profesionale për përdoruesit e makinerive të rënda për punime ndërtim dhe tokë, si dhe disiplinimi i përdorimit të tyre”, miratuar me urdhërin Nr. 200, datë 16.5.2019, të Ministrit të Infrastrukturs dhe Energjitikës dhe referuar Kodit Rrugor, e cila duhet te perkoje me kerkesat e profilit te deklaruar per cdo punojes.
- Të figurojnë në listpagesat e E-Sig minimalisht për periudhën e 3 (tre) muajve të fundit nga data e hapjes së ofertave, ku punojesit e mësipër duhet të figurojnë te rregjistruar sipas legjislacionit ne fuqi.
- Gjate fazes se ofertimit në plotësimin e formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, pika B. Deklarata -“Për disponimin e punonjësve të nevojshëm për realizimin e punimeve objekt kontrate”, operatorët ekonomik per punonjesit eskavatoriste, automakinist, buldozerist, duhet të deklarojnë: emer/mbiemer, profilin e punes, daten e kontrates se punes, numrin e deshmise së aftësisë profesionale dhe daten e vlefshmerise se saj.

Kur mjetet janë marrë me qira nga persona fizik, të cilat janë në pronësi të këtyre të fundit, atehere eskavatorist/automakinistet/buldozerist, dhe shoferet nuk ka nevojë që të figurojnë në listëpagesat përkatëse të O.E. ofertues.

Ne rastin e bashkimit te operatoreve ekonomik, cdo anetar i grupit duhet te paraqese punojesit e mesiperm, në përputhje me përqindjen dhe/ose natyrën e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në aktmarrëveshje.

AK rezervon te drejten e verifikimit te deklarimeve per punojesit e mesiperm, cdo informacion i rreme apo i devijuar nga kerkesat e mesiperme do te jete kusht per skualifikimin e ofertes.

Argumentimi: Kjo kërkesë mbështetet në Ligjin Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar), Neni 77, pika 4; në VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (i ndryshuar) Neni 39, pika 6, gërma “c”.

Duke marrë në konsideratë natyrën e punimeve; makineritë që do të kërkohen për realizimin e punimeve si dhe Preventivin e pritshëm të Punimeve shtron nevojën që Ofertuesit të kenë të punësuar **Punonjes Manovrator/Shofer** me qëllim realizimin e kontratës me sukses. Numri i këtyre punonjësve është përcaktuar duke marrë në konsideratë volumet e punimeve të gërmimit me eskavator , transportit të materialeve etj.

2.3.8 (Makineri, Pajisje)

- a) **Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e kontratës, duhet të disponojë**, automjetet, makineritë dhe pajisjet (**sipas tabelës**) të cilat duhet të jenë në pronësi të tij, qira ose kontratë furnizimi, të vërtetuara këto me dokumentacionin përkatës;

Nr	Mjetet	Sasia	Statusi
1	Kamiona vetëshkarkues me kapacitet mbajtës mbi 20 Ton	2 (dy) copë	Pronësi ose me qera
2	Kamiona vetëshkarkues me kapacitet mbajtës 10-20 ton	2 (dy) copë	Pronësi ose me qera
3	Kamiona vetëshkarkues me kapacitet mbajtës 5-10 Ton	2 (dy) copë	Pronësi ose me qera
4	Kamionçina me kapacitet mbajtës deri në 3.5 ton	3 (tre) copë	Pronësi ose me qera
5	Fadrome me targa(MT)	2 (dy) copë	Pronësi ose me qera
6	Eskavator me goma 0.25m3 (MT)	2 (dy) copë	Pronësi ose me qera
7	Minieskavator me targa (MT)	1 (një) copë	Pronësi ose me qera
8	Minifadrome	3 (tre) copë	Pronësi ose me qera
9	Minidumper pesha mbajtese 2 - 5 ton (MT)	1 (një) copë	Pronësi ose me qera
10	Trencher për hapje kanali min 20 ton	1 (një) copë	Pronësi ose me qera
11	Koke terheqese dhe Rimorkiator per transport mjetesh te renda	1 (një) copë	Pronësi ose me qera
12	Auto vinç kapacitet mbajtes min 10 ton	1 (një) copë	Pronësi ose me qera
13	Auto vinç kapacitet mbajtes min 5 ton	2 (dy) copë	Pronësi ose me qera
14	Eskavator me zinxhir + çekiç (matrapik)	2 (dy) copë	Pronësi ose me qera
15	Eskavator me zinxhir mbi 20 ton	2 (dy) copë	Pronësi ose me qera
16	Rrul me vibrim për ngjeshje shtresash (hekur gome)	2 (dy) copë	Pronësi ose me qera
17	Rrul per asfalte (hekur hekur)	2 (dy) copë	Pronësi ose me qera
18	Asfaltoshtruese	2 (dy) copë	Pronësi ose me qera
19	Prerëse asfalti / betoni - Sharrë asfalti /betoni	2 (dy) copë	Pronësi ose me qera
20	Grejder me goma	1 (një) copë	Pronësi ose me qera
21	Autobitumatriçe	1 (një) copë	Pronësi ose me qera
22	Autobetonierë	3 (tre) copë	Pronësi ose me qera
23	Autopompë betoni	2 (dy) copë	Pronësi ose me qera
24	AutoBetonierë kantieri MT (me targa) 2 - 3.5 m ³	2 (dy) copë	Pronësi ose me qera
25	Betoforma (armaturë)	1000 m ²	Pronësi ose me qera
26	Kontenier Stacioner (zyre ne objekt)	1 (një) copë	Pronësi ose me qera
27	Pajisje për hekurkthyes (tranxhë / elektrobango)	1 (një) copë	Pronësi ose me qera
28	Makineri shpimi horizontal HDD për kalimin e tubacioneve me system MIX dhe system elektronik (Remont Display)	1 (një) copë	Pronësi ose me qera
29	Autobot pajisur me pompe presioni dhe pompe vakumi veteshkarkuese e pajisur edhe me depozite per transport te ujit te paster dhe mbetjeve te tjera per testimin e rrjetit	1 (një) copë	Pronësi ose me qera
30	Automjet teknologjik për pastrimin e tubacioneve të kanalizimeve, i pajisur me sistem pastrimi me ujë me presion dhe sistem vakumi për thithjen dhe grumbullimin e materialeve/mbetjeve të larguara nga tubacionet dhe pusetat, i përshtatshëm për pastrimin, shpëlarjen dhe përgatitjen e rrjetit të kanalizimeve për kontrollin dhe vënien në funksion.	1 (një) copë	Pronësi ose me qera

31	Makineri teknologjike (autobot per transport te ujerave te zeza dhe e paisur me pompe me presion per larjen e pusetave) jo me shum se 1m3.	1 (një) copë	Pronësi ose me qera
32	Vibrator Betoni	2 (dy) copë	Pronësi ose me qera
33	Matrapik	2 (dy) copë	Pronësi ose me qera
34	Autobot uji	1 (një) copë	Pronësi ose me qera
35	Makine per ngjitje tubash (referuar specifikimeve te tubave)	2 (dy) copë	Pronësi ose me qera
36	Gjenerator	2 (dy) copë	Pronësi ose me qera
37	Nivelues/Helikopter betoni	1 (një) copë	Pronësi ose me qera
38	Fabrike per inerte me leje mjedisore QKL	1(një) copë	Pronësi ose me qera/ kontrate furnizimi
39	Instrument për punime gjeodezike	1(një) copë	Pronësi ose me qera
40	Total Station	1(një) copë	Pronësi ose me qera
41	Lazer për shtrimin dhe nivelimin e tubacioneve (Pipe Laser), i përshtatshëm për përcaktimin dhe kontrollin e aksit, kuotës dhe pjerrësisë gjatë shtrimit të tubacioneve të rrjetit të kanalizimeve.	1 (një) copë	Pronësi ose me qera

Pajisjet dhe mjetet nuk duhet te jene te angazhuara në asnjë kontratë tjetër publike, që bie ndesh me legjislacionin e fushës së ndërtimit, dhe do të angazhohet vetëm për realizimin e këtij objekti.

Si dëshmi për të vërtetuar disponimin e mjeteve dhe pajisjeve teknike ne pronesi/qira, do të paraqiten keto dokumenta:

- Për mjetet ne pronesi (që shënohen në regjistra publikë), duhet të paraqiten;- dokumenti që verteton regjistrimin e mjetit (leje qarkullimi), plus certifikaten e kontrollit teknik, -siguracionin e mjetit (te vlefshme), vertetimin e pageses per taksat vjetore.
- Për mjetet e siguruar me qira, duhet të paraqiten; -dokumenti qe verteton regjistrimin e tij (leje qarkullimi), plus certifikaten e kontrollit teknik, siguracionin e mjetit, (te vlefshme), vertetimin e pageses per taksat vjetore, kontrata e qirase e vlefshme per te gjithë periudhen e realizimit te kontrates objekt i ketij prokurimi.
- Për mjetet dhe pajisjet që nuk shënohen në regjistra publike duhet të paraqiten dokumentat që vërtetojnë pronësinë e tyre, apo marrjen me qira te tij.

Operatori/et ekonomik ofertues duhet te deklaroje qe te gjitha mjetet dhe pajisjet e pershkruara, do te jene te angazhuara vetem ne kete kontrate. Mjetet te cilat rezultojne te angazhuara ne kontrata te tjera afati i zbatimit te cilave shtrihet pergjate afatit te kontrates objekt i prokurimit jane shkak skualifikimi. Autoriteti Kontraktor gezon te drejten te verifikojte dhe kontrolloje disponueshmerine e ketyre mjeteve si gjate vleresimit te ofertave ashtu edhe gjate zbatimit te kontrates.

* Kriteri konsiderohet i përmbushur me vetëdeklarimin sipas Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimi, sipas shtojcës nr. 8. Formulari i vetëdeklarimit duhet të përmbajë kërkesat e autoritetit. Autoriteti/enti kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari, dorëzimin e dokumenteve provuese

Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më sipër, ose t'i kërkojë operatorit sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime, në përputhje me nenin 26, pika 7, të VKM nr.285, datë 19.05.2021, "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik".

b) Gjithashtu në zbatim të VKM-së Nr.312, datë 05.05.2010, operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të disponojë mjete dhe pajisje mbrojtjes në punë të punëtorëve, personelit, si më poshtë:

- Kokore – jo më pak se 40 copë
- Jelek për kantier fosforoshent - jo më pak se 40 opë
- Komplet i ndihmës së shpejtë – jo më pak se 5 copë
- Fikëse zjarri të lëvizshme – jo më pak se 10 copë
- Tabela paralajmëruese për sigurinë në objekt – jo më pak se 10 copë
- Prozhektorë ndriçimi natën minimumi – jo më pak se 4 copë

□ **Për përmbushjen e këtij kushti, operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të deklarojë sipas formës së disponimit të mjeteve/ makinerive dhe pajisjeve të kërkuara më lart, në seksionin përkatës të Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të shtojcës 8 në DST, dhe në rast se kualifikohet, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, duhet të paraqiten:**

1- Për mjetet me goma që shënohen në regjistra publike duhet të paraqitet dokument që vërteton Rregjistrimin e mjetit (*leje qarkullimi*), Çertifikatën e Kontrollit Teknik (*të vlefshme*), Siguracionin e mjetit (*të vlefshme*), Taksat e paguara, Leje e transportit (*vetëm për kamionët dhe kamionçinat*) dhe foto e dukshme të mjetit.

2- Për mjetet e siguruar me qira , të paraqitet kontrata noteriale e lidhur e qerash, e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës objekt e këtij prokurimi, shoqëruar me Akt - Pronësie origjinal ose fotokopje të noterizuar plus dokumentat që vërteton Rregjistrimin e mjetit (*leje qarkullimi*), Çertifikatën e Kontrollit Teknik (*të vlefshme*), Siguracionin e mjetit (*të vlefshme*), Taksat e paguara, Leje e transportit (*vetëm për kamionët dhe kamionçinat*) dhe Foto e dukshme të mjetit.

- Për mjetet që shënohen në regjistrat publik, kur janë në pronësi, duhet të paraqitet dokumentacioni që vërteton pronësinë e mjetit: Çertifikatën e pronësisë; lejen e qarkullimit; certifikatën e kontrollit teknik; siguracionin; lejen e transportit që lëshohet nga njësia vendore dhe fotot përkatëse;
- Ndërsa për mjetet e marra me qira, krahas dokumentacionit të mësipërm, duhet të paraqitet edhe kontrata e qirasë, e cila duhet të jetë e vlefshme për të gjithë periudhën deri në përfundimin e plotë të punimeve.
- Për mjetet që nuk shënohen në regjistra publike, kur janë në pronësi, duhet të paraqitet kontrata e blerjes ose fatura e zhdoganimit ose fatura tatimore përkatëse, fotot, ndërsa për mjetet e marra me qira, krahas dokumentacionit të mësipërm, duhet të paraqitet edhe kontrata e qirasë, e cila

duhet të përfshijë objektin përkatës dhe duhet të jetë e vlefshme për të gjithë periudhën deri në përfundimin e plotë të punimeve.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/ç dhe 6/d, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë fuqinë minimale punëtore, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, si dhe mjetet e pajisjet teknike, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

Për të përcaktuar numrin e mjeteve/makinerive të nevojshme për realizimin e kontratës, janë hartuar analizat teknike, sipas legjislacionit të fushës bazuar në VKM nr. 216, datë 13.4.2023 “Për krijimin dhe funksionimin e sistemit të integruar për informatizimin e manualit të çmimeve për zërat e punimeve në ndërtim”

Numri dhe lloji i makinerive, paisjeve në pronesi / qira janë vlerësuar si të nevojshme në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës, duke i’u referuar punimeve sipas standardeve, grafikut, kohëzgjatjes së punimeve dhe specifikimeve teknike të projekt zbatimit. Për të zbatuar kontratën, operatorët ekonomikë duhet të përmbushin kapacitetet teknike të pajisjeve dhe aseteve të tjera fizike, për këtë janë përcaktuar edhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin ofertuesit. Nëpërmjet kapaciteteve teknike operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë aftësinë dhe kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, aftësitë organizative. Pajisjet dhe mjetet e mësipërme janë të lidhura ngushtë me objektin e kontratës dhe i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e kapaciteteve dhe të mundësisë së operatorit për përmbushjen me sukses të kontratës si dëshmi për mjetet dhe pajisjet sipas specifikave.

Kërkesat për mjetet dhe pajisjet argumentohen me natyrën multidisiplinare të punimeve të pritshme: gërmime dhe transport, shtrim tubacionesh, struktura betonarme, instalime/montime, rehabilitim të sipërfaqeve, punime topogjeodezike, pastrim, testim dhe vënie në funksion. Meqenëse kontrata është e tipit “Projektim–Zbatim” dhe nuk ka ende projekt zbatimi/preventiv të detajuar, parametrat dhe sasitë specifike duhet të jenë proporcionale me kërkesat funksionale të Autoritetit Kontraktor dhe të mos paracaktojnë pa nevojë metodologjinë përfundimtare të zbatimit.

Nr.	Mjeti/Pajisja	Sasia	Argumentimi i nevojës	Vërejtje
1	Kamion vetëshkarkues >20 ton	2	Transporti i sasive të mëdha të dherave nga gërmimet, materialeve të mbushjes dhe inerteve për rrjetin e kanalizimeve dhe impiantin.	E lidhur me objektin.
2	Kamion vetëshkarkues 10–20 ton	2	Transporti i dherave, inerteve dhe materialeve në segmente ku kërkohet mjet me kapacitet mesatar dhe manovrim më i lehtë.	E lidhur me objektin.
3	Kamion vetëshkarkues 5–10 ton	2	Transport lokal i materialeve dhe mbetjeve në fronte pune me akses të kufizuar.	E lidhur me objektin.
4	Kamionçinë deri 3.5 ton	3	Transporti i personelit, veglave, materialeve të vogla dhe pajisjeve ndërmjet fronteve të punës.	E lidhur me objektin.
5	Fadromë me targa (MT)	2	Ngarkim, zhvendosje dhe sistemim i dherave e inerteve, mbushje kanalesh dhe sistemim terreni.	E lidhur me objektin.
6	Eskavator me goma 0.25	2	Gërmime për kanale, puseta dhe punime ndihmëse, veçanërisht në zona urbane ose me	E lidhur me

	m ³ (MT)		nevojë për lëvizshmëri.	objektin.
7	Miniekskavator me targa (MT)	1	Gërmime precize në hapësira të kufizuara, pranë rrjeteve ekzistuese dhe për lidhje/puseta.	E lidhur me objektin.
8	Minifadromë	3	Ngarkim, nivelim dhe sistemim materiale në hapësira të kufizuara dhe fronte të shpërndara.	E lidhur me objektin.
9	Minidumper 2–5 ton (MT)	1	Transport i dherave dhe materialeve brenda kantierit ose në zona ku kamionët e mëdhenj nuk aksesojnë.	E lidhur me objektin.
10	Trencher për hapje kanali min. 20 ton	1	Hapje mekanike e kanaleve për tubacione, me produktivitet të lartë në trase të përshtatshme; nevoja për parametrin 20 ton duhet të mbështetet nga kërkesat funksionale.	Parametri min. 20 ton të justifikohet.
11	Kokë tërheqëse dhe rimorkio për mjete të rënda	1	Transporti dhe mobilizimi i ekskavatorëve, fadromave dhe makinerive të tjera të rënda ndërmjet fronteve.	E lidhur me objektin.
12	Autovinç kapacitet min. 10 ton	1	Ngjitja dhe montimi i pajisjeve teknologjike, elementeve të rënda, pusetave dhe komponentëve të impiantit.	E lidhur me objektin.
13	Autovinç kapacitet min. 5 ton	2	Ngjitje dhe montime të elementeve me peshë të moderuar në fronte të ndryshme pune.	E lidhur me objektin.
14	Eskavator me zinxhir + çekiç (matrapik)	2	Gërmime në terrene të forta dhe prishje të betonit/shkëmbit ose strukturave ekzistuese.	E lidhur me objektin.
15	Eskavator me zinxhir mbi 20 ton	2	Gërmime masive për strukturat e impiantit, kanale të thella dhe lëvizje dherash.	E lidhur me objektin.
16	Rrul vibruës për ngjeshje shtresash (hekur–gomë)	2	Ngjeshja e mbushjeve, nënbazave dhe shtresave të rikthyera pas punimeve.	E lidhur me objektin.
17	Rrul për asfalt (hekur–hekur)	2	Ngjeshja e shtresave asfaltike gjatë rehabilitimit të rrugëve të prekura.	E lidhur me objektin.
18	Asfaltoshtruese	2	Rivendosja e shtresave asfaltike në segmentet rrugore të dëmtuara nga hapja e kanaleve; sasia duhet lidhur me frontet e pritshme.	2 copë duhen justifikuar me fronte pune.
19	Prerëse/Sharrë asfalti-betoni	2	Prerje e kontrolluar e asfaltit dhe betonit për hapjen e traseve dhe kufizimin e dëmtimeve.	E lidhur me objektin.
20	Grejder me goma	1	Profilim dhe nivelim i shtresave rrugore, shesheve dhe rrugëve të brendshme të impiantit.	E lidhur me objektin.
21	Autobitumatriçe	1	Spërkatje bituminoze për lidhjen e shtresave gjatë rehabilitimit të sipërfaqeve rrugore.	E lidhur me objektin.
22	Autobetonierë	3	Transport dhe furnizim me beton për rezervuarë, basene, themele, puseta dhe struktura	E lidhur me

			betonarme.	objektin.
23	Autopompë betoni	2	Hedhja e betonit në struktura ku shkarkimi direkt nga autobetoniera nuk është i mundur.	2 copë duhen justifikuar me volum/fronte.
24	Autobetonierë kantieri MT 2–3.5 m³	2	Përgatitje/transport i sasive më të vogla të betonit brenda kantierit dhe në fronte të vështira për akses.	E lidhur me objektin.
25	Betoforma (armaturë)	1000 m²	Realizimi i kallëpeve për mure, basene, rezervuarë, themele dhe elemente të tjera betonarme.	E lidhur me objektin.
26	Kontenier stacionar (zyrë në objekt)	1	Organizimi i administrimit të kantierit, dokumentacionit teknik, mbledhjeve dhe koordinimit të punimeve.	E lidhur me objektin.
27	Pajisje për hekurkthyes (tranxhë/elektrobango)	1	Prerja, kthimi dhe përpunimi i armaturës së çelikut për strukturat betonarme.	E lidhur me objektin.
28	Makineri shpimi horizontal HDD	1	Realizimi i kalimeve të tubacioneve pa kanal të hapur nën rrugë ose pengesa; duhet kërkuar vetëm kur kërkesat funksionale parashikojnë kalime të tilla.	Kushtëzohet nga kalimet pa kanal të hapur.
29	Autobot me pompë presioni dhe vakumi, depozitë uji/mbetjesh	1	Pastrimi, shpëlarja, thithja e materialeve dhe mbështetja e testimit/përgatitjes së rrjetit për vënie në funksion.	E lidhur me objektin.
30	Automjet teknologjik për pastrim tubacionesh, presion + vakum	1	Pastrimi dhe shpëlarja e tubacioneve e pusetave dhe largimi i sedimenteve para kontrollit, testimit dhe vënies në funksion.	E lidhur me objektin.
31	Autobot për ujëra të zeza me pompë presioni, ≤1 m³	1	Transport i ujërave të ndotura dhe larje e pusetave në ndërhyrje lokale; funksioni mbivendoset pjesërisht me mjetet nr. 29–30 dhe duhet rivlerësuar.	Rivlerësohet për mbivendosje me nr. 29–30.
32	Vibrator betoni	2	Kompaktimi i betonit të freskët për eliminimin e boshllëqeve dhe sigurimin e cilësisë së strukturave.	E lidhur me objektin.
33	Matrapik	2	Prishje lokale të betonit, asfaltit ose materialeve të forta gjatë hapjes dhe përshtatjes së traseve.	E lidhur me objektin.
34	Autobot uji	1	Furnizim me ujë për kantierin, kontrollin e pluhurit, pastrimin dhe procese ndihmëse të ndërtimit.	E lidhur me objektin.
35	Makinë për ngjitje tubash	2	Bashkimi/saldimi i tubacioneve sipas materialit dhe teknologjisë së përcaktuar nga projekti dhe specifikimet e tubave.	E lidhur me objektin.

36	Gjenerator	2	Furnizim i përkohshëm me energji për pajisjet, veglat dhe proceset e kantierit në mungesë ose ndërprerje të rrjetit elektrik.	E lidhur me objektin.
37	Nivelues/Helikopter betoni	1	Nivelimi dhe përfundimi i sipërfaqeve të betonit në dysheme, pllaka dhe sheshe teknike.	E lidhur me objektin.
38	Fabrikë për inerte me leje mjedisore	1	Sigurimi i furnizimit me materiale inerte për mbushje dhe shtresa; më proporcional është të pranohet edhe kontratë furnizimi me burim të ligjshëm/autorizuar.	Të pranohet edhe kontratë furnizimi.
39	Instrument për punime gjeodezike	1	Matje topografike, piketime dhe kontroll i kuotave/akseve gjatë projektimit dhe zbatimit.	E lidhur me objektin.
40	Total Station	1	Matje precize të koordinatave, kuotave dhe pozicionimit të rrjetit e strukturave, si dhe dokumentacioni as-built.	E lidhur me objektin.
41	Lazer për shtrimin dhe nivelimin e tubacioneve (Pipe Laser)	1	Kontrolli i aksit, kuotës dhe pjerrësisë gjatë shtrimit të tubacioneve, veçanërisht për kanalizimet me gravitet.	E lidhur me objektin.

2.3.9 Operatori ekonomik duhet të ketë kontratë mes palëve me një laborator testimi të betonit, i cili duhet të jetë i akredituar nga organizma kombëtar ose ndërkombëtar sipas standarteve SSHEN ISO SSH EN ISO 12350-2:2019, SSH EN ISO 12504-2:2021, SSH EN ISO 6892 - 1:2019, SSH EN 1 ISO 2390-8:2019, SSH EN 12697- 5:2018, SSH EN 1426 :2015 ose ekuivalente.

Argumentimi: AK argumenton se kërkesa për një laborator testimi të betonit dhe asfaltit, i cili duhet të jetë i akredituar nga organizma kombëtar ose ndërkombëtar është vendosur sipas përcaktimeve të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, Neni 77, pika 4, si dhe në VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar Kreu V, Seksioni III, Neni 39, pika 2 dhe 4.

2.3.10 Operatori ekonomik duhet të paraqesë, për tubat e brinjëzuar HDPE të propozuar:

- a) **Autorizim të prodhuesit**, ose autorizim/deklaratë nga distributori i autorizuar prej prodhuesit, ose marrëveshje bashkëpunimi/furnizimi, dokument që duhet të evidentojë lidhjen ndërmjet operatorit ekonomik dhe prodhuesit, drejtpërdrejt ose nëpërmjet distributorit të autorizuar.

Dokumenti duhet të identifikojë qartë prodhuesin dhe produktin/produktet e propozuara dhe të përmbajë të dhëna të mjaftueshme identifikuese dhe kontakti të prodhuesit, me qëllim verifikimin e autenticitetit të dokumentacionit nga Autoriteti Kontraktor.

- b) **Katalogun, skedën teknike (Technical Data Sheet) ose pjesë të dokumentacionit teknik të prodhuesit**, për tubat e brinjëzuar HDPE të propozuar, nga të cilat të evidentohen karakteristikat teknike të produktit dhe përputhshmëria e tij me kërkesat minimale të përcaktuara në dokumentet e tenderit.

Dokumentacioni teknik duhet të mundësojë identifikimin e qartë të prodhuesit dhe të produktit të propozuar.

Dokumentet e lëshuara në gjuhë të huaj të paraqiten në përputhje me kërkesat për gjuhën e dokumentacionit të përcaktuara në dokumentet e tenderit.

Në rast bashkimi të operatorëve ekonomikë, dokumentacioni i mësipërm paraqitet nga anëtari/anëtarët e bashkimit që, sipas marrëveshjes së bashkëpunimit dhe ndarjes së punëve, marrin përsipër furnizimin dhe/ose instalimin e tubacioneve përkatëse.

Shënim: Diametrat, sasitë dhe karakteristikat përfundimtare të tubacioneve do të përcaktohen në projektin e zbatimit, mbi bazën e llogaritjeve hidraulike dhe strukturore dhe në përputhje me kërkesat minimale të Autoritetit Kontraktor.

Referencat ndaj standardeve teknike në dokumentet e tenderit do të kuptohen të shoqëruara me shprehjen “ose ekuivalent”, kur kjo është e aplikueshme.

Argumentimi : Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, nenin 39, pika 8, si dhe në bazë të nenit 45, pika 1 të VKM-së Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar.

Kërkesa për paraqitjen e autorizimit/deklaratës së prodhuesit ose distributorit të autorizuar, apo marrëveshjes së bashkëpunimit/furnizimit, si dhe dokumentacionit teknik për **tubat e brinjëzuar HDPE**, është vendosur duke marrë në konsideratë rëndësinë që ky material ka në realizimin dhe funksionimin e rrjetit të kanalizimeve, si pjesë thelbësore e objektit të kontratës. Tubacionet e kanalizimeve përbëjnë elemente të përhershme të veprës, të cilat pas instalimit vendosen nëntokë dhe duhet të sigurojnë funksionimin e rrjetit për një periudhë të gjatë. Për shkak të pozicionimit të tyre nëntokësor, defektet ose mospërputhjet e materialeve mund të sjellin ndërhyrje të vështira dhe kosto të konsiderueshme për riparimin ose zëvendësimin e tyre. Për këtë arsye, sigurimi i cilësisë, identifikueshmërisë dhe gjurmueshmërisë së produktit të propozuar paraqet rëndësi të veçantë për realizimin e kontratës.

Kërkesa për autorizimin/deklaratën ose marrëveshjen e furnizimit synon të dokumentojë ekzistencën e një burimi të identifikueshëm furnizimi për tubacionet e propozuara dhe të mundësojë verifikimin nga Autoriteti Kontraktor të prodhuesit, produktit dhe dokumentacionit të paraqitur. Pranimi alternativ i autorizimit të prodhuesit, dokumentit të distributorit të autorizuar ose marrëveshjes së bashkëpunimit/furnizimit synon që plotësimi i kërkesës të mos kufizohet vetëm në një formë të marrëdhënies tregtare ndërmjet ofertuesit dhe furnizuesit.

Kërkesa për katalogun, skedën teknike (Technical Data Sheet) ose dokumentacionin teknik të prodhuesit është e nevojshme për të mundësuar verifikimin objektiv të karakteristikave teknike të tubave të propozuar dhe përputhshmërisë së tyre me kërkesat minimale teknike të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Dokumentacioni duhet të identifikojë qartë produktin dhe prodhuesin, në mënyrë që të mundësohet kontrolli i të dhënave teknike të deklaruara nga operatori ekonomik.

Duke qenë se procedura e prokurimit është e tipit “**Projektim–Zbatim**”, në fazën e ofertimit nuk janë përcaktuar përfundimisht diametrat, sasitë, thellësitë e instalimit, pjerrësitë dhe

konfigurimi i plotë i tubacioneve. Këto të dhëna do të përcaktohen gjatë hartimit të projektit të zbatimit, mbi bazën e llogaritjeve hidraulike dhe strukturore dhe kushteve konkrete të terrenit.

Për këtë arsye, kriteri nuk kërkon që operatori ekonomik të përcaktojë në fazën e ofertimit sasi të dhe dimensionet përfundimtare të të gjithë tubacioneve, por synon të verifikojë që produkti/familja e produkteve të propozuara ka një prodhues dhe burim furnizimi të identifikueshëm dhe se karakteristikat teknike të deklaruara mund të verifikohen nëpërmjet dokumentacionit zyrtar teknik të prodhuesit.

Parashikimi i shprehjes “**ose ekuivalent**” për standardet teknike synon pranimin e produkteve që përmbushin kërkesat teknike dhe të performancës nëpërmjet standardeve ekuivalente, duke mos e kufizuar përmbushjen e kërkesës në një standard apo prodhues të caktuar.

Në këtë mënyrë, kriteri lidhet drejtpërdrejt me objektin e kontratës dhe synon të krijojë siguri mbi **cilësinë, origjinën, gjurmueshmërinë, disponueshmërinë dhe verifikueshmërinë teknike** të një prej materialeve kryesore që do të përdoren për realizimin e rrjetit të kanalizimeve.

2.3.11 Operatori Ekonomik duhet të disponojë:

Licence të leshuar nga Qendra Kombëtare e Biznesit (QKB) Kodi III.2.B (Për grumbullim dhe transport të mbetjeve inerte dhe të ngurta), së bashku me aktin e miratimit, në përputhje me parashikimet e vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 538, datë 26.5.2009 “Për licencat dhe lejet që trajtohen nga apo nëpërmjet Qendrës Kombëtare të Licencimit (QKL) dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashkëta”, i ndryshuar, e shoqëruar me Aktin e Miratimit.

Argumentimi : Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 39, pika 6/a, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar, si dhe në nenin 4, pika e 1/b e ligjit nr. 10448, datë 14.7.2011 “Për lejet e mjedisit” i ndryshuar, ku parashikohet se: “*leja e mjedisit e tipit B është e detyrueshme për kryerjen e veprimtarive të kategorisë B, lista dhe pragjet përkatëse të të cilave janë përcaktuar në shtojcën 1/B të këtij ligji*”.

Në shtojcën 1/B është listuar edhe veprimtaria “Menaxhimi i mbetjeve”.

Në nenin 57/2 të ligjit nr. 10463, datë 22.9.2011 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”, i ndryshuar, parashikohet se: “Qendra Kombëtare e Licencimit lëshon licencën **për transportin e mbetjeve**, e cila përfshihet në nënkategorinë III.2.B të fushës III të vendimit nr. 538, datë 26.5.2009 të Këshillit të Ministrave “Për licencat dhe lejet që trajtohen nga/apo nëpërmjet Qendrës Kombëtare të Licencimit (QKL) dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashkëta”, pas miratimit të saj nga ministri”.

Ndërkohë, sipas VKM nr. 538, datë 26.5.2009 “Për licencat dhe lejet që trajtohen nga apo nëpërmjet qendrës kombëtare të licencimit (qkl) dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashkëta”: “Veprimtaria e nënkategorisë III.2.B specifikohet në veprimtari të tilla si grumbullim, transportim, ruajtje, riciklim, përpunim apo asgjësim i mbetjeve të llojeve të ndryshme”.

2.3.12 Operatori ekonomik duhet të dorëzojë Grafikun e punimeve në përputhje me zërat e punës të jetë në përputhje me afatin kohor në dokumentet e tenderit. Afati i kryerjes së punimeve është 24 (njëzet e katër) muaj i ndarë sipas fazave më poshtë:

- Afati për hartimin e projektit për “Ndërtimi i KUZ Borsh” do të jetë 4 muaj.

- Afati për “Ndërtimi i KUZ Borsh” do të jetë 20 muaj.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në Nenin 79 të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, Nenin 39, pika 3 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.

Në të gjitha rastet ku është përmendur fjala markë, Autoriteti Kontraktor do të pranojë edhe “ekuivalentin” e tij/tyre.

Në të gjitha rastet kur AK në specifikimet teknike i është referuar vetëm standarteve europiane, Autoritetit Kontraktor do të pranojë edhe paraqitjen e standarteve SSH/DIN/UNI/EN/ISO.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.

Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente me të dhëna të rreme ose të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

NJESIA E PROKURIMIT